



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 591, datë 18.10.2023

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIU DHËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Irena Plaku,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmyja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PËRCAKTIMI I NIVELIT TË VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Përcaktimi i objektit të mosmarrëveshjes që i paraqitet gjykatës për zgjidhje është në disponibilitetin ekskluziv të palëve, por nga ana tjetër në mbështetje të nenit 16 të K.Pr.Civile është gjykata ajo që bën një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi dhe për rrjedhojë nuk është e lidhur as me bazën apo referencën ligjore të palës paditëse. Gjithashtu në bazë të nenit 375 të K.Pr.Penale pavarësisht akuzës së ngritur nga ana e organit të akuzës, me vendimin përfundimtar gjykata mund t'i japë faktit një përcaktim të ndryshëm nga ai që ka bërë prokurori me kusht që vepra penale të jetë në kompetencën e saj.

Sa më sipër, roli i gjykatës në identifikimin e natyrës së çështjes dhe ligjin e zbatueshëm paraqet rëndësi thelbësore për një sërë çështjesh eventuale, që do të duhet të zgjidhë gjykata në përfundim të gjykimit, që në kontekstin e të tërës përkthehet me aksiomën juridike “*Iura novit curia*” – “Gjykata e

njeh ligjin”. Në këtë kontekst, gjykatës i duhet të përcaktojë drejt faktet e çështjes, fakt ky i cili do të përcaktojë edhe natyrën juridike të saj, e për pasojë edhe referencën relevante për zbatim në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Në raportin Raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “...*Nga vlerësimi i dosjeve të zgjedhura me short dhe atyre të dorëzuara nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se znj. {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara, është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Natyra e çështjeve që subjekti ka shqyrtuar ka qenë e ndryshme. Një rëndësi të veçantë i kushtohet edhe respektimit ose jo të dispozitave procedurale nga gjykatat më të ulëta, por nuk janë evidentuar shkelje...*”

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja përshkuan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim gjatë gjykimit në shkallë të parë.

Duke u nisur nga mënyra se si janë pasqyruar rrethanat e çështjes, në të gjitha vendimet e nënshtuara kësaj analize, pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale*) apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, apo gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi në çështjet civile*), faktet parashtrihen në pjesën e parë të pjesës përshkuese - arsyetuese të vendimit. Pavarësisht se nuk rezulton si një nën pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes në përputhje dhe në mënyrë të integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Tipar i vendimeve është analiza e detajuar e të gjitha provave të marra në gjykim dhe fuqia provuese e tyre në funksion të konkluzionit mbi ekzistencën ose jo të faktit penal dhe cilësimin juridik të tij, apo në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në çështjet civile.

Gjyqtarja i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, që nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit.. Nuk konstatohet ndonjë rast që gjyqtarja të këtë bërë ndonjë pasqyrim të rrethanave të çështjes ndryshe nga ajo e konstatuar nga gjykata e shkallës së parë, pasi në të gjitha vendimet rezulton pasqyrimi i të njëjtit fakt si ai përshkruar në vendimin e shkallës së parë objekt ankimi. Pavarësisht këtij konstatimi, gjyqtarja tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*i ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi.

Në çdo vendim gjyqësor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon, për cilësim të saktë të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi. Kjo sepse përcaktimi i saktë i faktit lidhet prej saj në çdo rast me analizimin e shkaqeve të ankimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

- Identifikimi i natyrës së çështjes:

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjyqtarja konkludon për natyrën e marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo penale. Përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve i jepet rëndësia e duhur nga ana e gjyqtarës, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën në lëndë dhe funksion të gjykatës dhe që përbën edhe një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë konform nenit 467 pg 1 gërma “a” e K.Pr.Civile. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që, edhe pse jo gjithmonë e shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë, gjyqtarja e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi. Ndërkohë, në vendimet e tjera gjyqësore (*civile apo penale*), natyra juridike e çështjes nuk është identifikuar në mënyrë specifike, por ajo del saktë referuar identifikimit të elementeve dhe kritereve ligjore të mosmarrëveshjes juridike.

- Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:

Përcaktimi i saktë i natyrës së çështjes nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë vetëm me kompetencën lëndore dhe funksionale të gjykatës për shqyrtimin e çështjes, por lidhet gjithashtu me identifikimin e ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Në këtë aspekt, referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (mosmarrëveshje pronësie, pune, shpërblim dëmi pasuror dhe jopasuror , lëshim dëshmie trashëgimie, shfuqizim vendimi KQZ apo lëshim urdhër mbrojtje), gjyqtarja identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse. Në vendimin gjyqësor me objekt ndryshimin e aktit administrativ të AKKP Tiranë,¹ gjyqtarja identifikon dispozitat ligjore materiale dhe procedurale njëkohësisht (nenin 309 të K.Pr.Civile) në lidhje me provat e marra dhe shqyrtuara gjatë gjykimit, dhe po kështu ligjet e posaçme nr. 9235/2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” apo, nr.7501/1991 “Për tokën”. Në vendimin gjyqësor me objekt lëshimin e urdhërit të mbrojtjes² gjyqtarja identifikon ligjin e posaçëm nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Ndërsa në vendimin me objekt shfuqizim i vendimeve të KQZ³ gjyqtarja identifikon ligjet e posaçme si Kodi Zgjedhor (ligji 9087/2003), ligji nr. 8580/2000 “Për partitë politike”, ligji 9904/2008 “Për disa ndryshime në Kushtetutën e e RSH”, ligji 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njërive të qeverisjes vendore në RSH”.

Nuk konstatohet që gjyqtarja të citojë dhe analizojë dispozita procedurale civile lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, pasi këto çështje nuk rezultojnë që të jenë bërë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor. Por në një vendim⁴, gjykata pasi ka kthyer çështjen për rigjykim i ka lënë si detyrë gjykatës të verifikojë mundësinë e gjykimit të të gjitha kërtimeve, duke bërë eventualisht ndarjen e tyre, duke mbajtur në vëmendje kompetencën lëndore të saj.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtarja identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Konkretisht, gjyqtarja identifikon nenin 291 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”,⁵ nenin 278/4 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve të zjarrit”⁶ dhe nenin 300 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Moskallëzimit të krimit”⁷.

¹ Vendimi nr.128, datë 21.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

² Vendimi Nr. 642, datë 06.10.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³ Vendim nr.1, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁴ Vendimin nr.1371, datë 09.04.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁵ Vendimi nr.346 datë 11.03.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë

⁶ Vendimi nr.1130 datë 29.07.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë

⁷ Po aty.

Në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtarja ndonjë rast konflikt i normave ligjore apo të jetë analizuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në një rast të caktuar. Nga ana tjetër, nuk konstatohet asnjë rast ku analiza e konfliktit të normave të ketë qenë e domosdoshme.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtares treguesin “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave”, vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Interpretimi i ligjit është ekskluzivitet i gjyqtarit, interpretim i cili duhet të bëhet duke dhënë kuptimin e saktë dhe të rregullt normës ligjore. Interpretimi, si funksion dhe metodë duhet ti japë jetë normave materiale dhe procedurale relevante, përmes kuptimit të drejtë të përmbajtjes dhe qëllimit të tyre në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: “Subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore, përfundimtare, të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të

kuptueshme, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsytimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Analiza ligjore është e thjeshtë, mjaftohet me tregimin e neneve ligjore të zbatueshme dhe me konkluzionin e zbatimit të tyre, duke përdorur fjali përgjithësuese...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normave juridike që gjëjnë zbatim (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore përmenden apo citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes. Citimi i dispozitave shoqërohet gjithmonë me interpretimit të tyre abstrakt dhe mbi faktin konkret ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato përdoren. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre në funksion të analizës juridike dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht përdor interpretimin ligjor të normës konkrete (*ratio legis - për të cilën ajo është krijuar*), dhe duke e përputhur me faktin juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, nxjerr konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht në mënyrë më specifike në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi rezulton se:

- Në vendimin me objekt “ përmbushje detyrimi”⁸ , për të përcaktuar përmbushjen e apo jo të një detyrimi kontraktor, gjyqtarja bën një interpretim të elementëve thelbësor të kontratës duke arritur në konkluzionin që një ndër ta, nga ku pretendohet se buron detyrimi, siç është çmimi i kontratës së shërbimit, nuk është treguar dhe vërtetuar në gjykim.

- Në vendimin me objekt “lirim dorëzim sendi”⁹ gjyqtarja analizon dhe interpreton dispozitat në lidhje me qiranë, specifiku nënin 820 të Kodit Civil që lidhet afatin e caktuar të qirasë dhe nenin 821 të KC që lidhet me përtëritjen e qirasë në lidhje me nenin 814 të KC që parashikon detyrimin e qiramarrësit për kthimin e sendit ku vlerëson se duhet vërtetuar fakti i vullnetit të qiradhënësit për kthimin e sendit; nenin 296 të KC në lidhje me të drejtën e pronarit për të kërkuar sendin nga çdo posedues, e drejtë e cila nuk mund të kufizohet as nga vetë bashkëpronari kundrejt bashkëpronarit tjetër.

- Në vendimin me objekt “ ndryshimin e vendimit të AKKP, njohjen e së drejtës së pronësisë dhe kthimin fizik”¹⁰ gjyqtarja bën një interpretim të përgjithshëm të këkesave të ligjit nr. 9235/2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” dhe VKM-së nr. 747, datë 09.11.2006 duke konkluduar në nevojën e një hetimi të mëtejshëm në lidhje me marrjen e të dhënave të trashëgimtarëve të subjektit të shpronësuar nëse kanë përfituar apo jo nga ligji “Për tokën”

-Në vendimin me objekt “lëshim urdhëri mbrojtje”, në përcaktimin e mjaftueshmërisë së provave të paraqitura për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes¹¹, gjyqtarja bën një interpretim të nenit 15, të ligjit nr.9669, datë 18.12.2006.

- Në vendimin me objekt “dëmshpërblimin nga marrëdhënia e punë”¹², gjyqtarja interpreton në përputhje me rrethanat e fakteve dhe provave të administruara, dispozitat materiale të Kodit të Punës duke evidentuar nenin 140 paragrafi i 2, në lidhje me kushtet që duhet të plotësojë një kontratë e lidhur me afat të caktuar; nenin 153, 155 në lidhje me kriteret që duhet të plotësohen për zgjidhjen e kontratës në mënyrë të menjëhershme; nenin 143, 144, 145 në lidhje me afatet e njoftimit dhe procedurën e ndjekur për zgjidhjen e kontratës së punës nga punëdhënësi dhe shpërblimi për vjetërsinë.

⁸ Vendimi nr.2297 datë 23.05.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

⁹ Vendimi nr.1058 datë 05.05.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁰ Vendimi nr.128 datë 21.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹¹ Vendimi nr.642 datë 06.10.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹² Vendimi nr.1038 datë 03.05.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë

-Në vendimin e Kolegjit Zgjedhor, me objekt “Shfuqizimin e vendimeve të komisionit qëndror të zgjedhjeve”¹³, gjyqtarja në lidhje me pretendimet e palëve analizon: nenet 153, 154 të Kodit Zgjedhor mbi formën dhe përmbajtjen e ankimit (detyrimin e paditësve për të treguar palët e interesuara); nenin 22/7 të K. Zgjedhor në lidhje me transparencën e mbledhjeve të KQZ, nenin 145 të KZ në lidhje me legjitimitetin e paditësit. Ky nen analizohet së bashku me frymën e ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 “Për partitë politike” dhe nenet 1, 2, 22, 26, 145, 152/2 të KZ duke vlerësuar si të ligjshëm interesin e palës paditëse pasi duke pasur parasysh karakterin publik të çështjeve zgjedhore, interesi i ligjshëm i partive parlamentare prezumohet; nenet 126, 126/1/2/5, 132/1, 2/7, 23, 2/7, 122, 124/2, 128 të Kodit Zgjedhor ndërthurur me analizën dhe interpretimin e neneve 153, 177, 150, 131, 151 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe disa vendime të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me kompetencën e KQZ-së për shqyrtimin e kërkesës për referendum vendor; nenet 132, 126/2, 1265, 127, 128/2 të K. Zgjedhor gërshetuar me analizën dhe interpretimin e neneve 108, 150 e vijues, 177, 108/4, 150/3, 151/2, 152 të Kushtetutës, të vendimeve 8/2003, 13/2013 dhe 25/2009 të Gj. Kushtetutës si dhe parimin e ushtrimit të sovranitetit nga populli në lidhje me të drejtën për të kërkuar zhvillimin e një referendumi vendor, si e drejtë kushtetuese dhe e parashikuar me ligj duke konkluduar në rregullat kushtetuese dhe ligjore që duhet të aplikohen në rastin e kërkesës për referendum vendor; nenet 2/1/2, 108/2/4, 152 të kushtetutës së RSH në frymën e Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore, ligjit 115/2014 “Për ndarjen administrative - territoriale të njësisë të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë” ndërthurur me analizën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese 25/2009, 31/2003, 29/2006 në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të KQZ-së objekt ankimi duke konkluduar që momenti procedural ku ndodhet procesi nuk lejon vijimin e mëtejshëm të procedurës së verifikimit nga KQZ-ja të nënshkrimeve dhe saktësisë së dokumentave identifikuese të zgjedhësve.

(ii) Në vendimet penale: Dispozitat penale interpretohen në funksion të përcaktimit të cilësimit juridik të veprës penale dhe përgjegjësisë së autorit në kryerjen e saj. Gjyqtarja interpreton normën relevante të K.Penal teorikisht duke i dhënë një përshkrim të përgjithshëm në lidhje me elementët dallues të veprës penale dhe në vijim, duke e përputhur me faktet dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, nxjerr konkluzionin në lidhje me përgjegjësinë penale të autorit. Konkretisht :

- Në vendimin nr. 1130/2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, gjyqtarja analizon veprën penale të “Moskallëzimit të krimit” (neni 300 i K.Penal) duke konkluduar se kjo vepër ka në bazën e saj kryerjen e një tjetër krimi, pa të cilin nuk mund të ekzistojë përgjegjësia penale për “moskallëzim”. Gjyqtarja analizon që nuk ka asnjë fakt penal lidhur me një krim konkret të kryer, për të cilin i pandehuri duhet të bënte kallëzim.

¹³ Vendimi nr.1 datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë (Kolegji Zgjedhor)

- Në vendimet e tjera penale nuk konstatohet që të jetë bërë ndonjë interpretim teorik i normës relevante penale në lidhje me veprat penale përkatëse që i atribuohen të pandehurve, (p.sh. nenit 298¹⁴ të K.Penal), por ky fakt konstatohet vetëm në këto raste kur cilësimi i faktit juridik dhe përgjegjësia penale e autorit në lidhje me kryerjen e këtyre veprave penale, nuk është bërë objekt kundërshtimi dhe ankimi në Apel.

Krahas interpretimit të dispozitave materiale penale të pjesës së posaçme në lidhje me kualifikimin e veprave penale përkatëse për të cilat akuzohen të pandehurit, evidentohet edhe interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh. në lidhje me individualizimin e dënimit (neni 59 të K.Penal) në të gjitha ato raste kur shkak i ankimit ka të bëjë pikërisht me masën e dënimit ose me aplikimin apo jo të alternativave të dënimit.¹⁵ Në këto raste gjyqtarja ndalet kryesisht në qëllimin, funksionin dhe kushtet që duhet të përmbushen për të përfituar i pandehuri nga një masë dënimi më e ulët apo edhe të një dënimi alternativ të parashikuar në nenin 59 të K.Penal.

- Përsa i përket interpretimit të dispozitave procedurale:

Gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normës jo vetëm përsa i përket të zgjidhjes në themel të çështjes, por edhe zgjidhjes së situatave procedurale, në rastin kur ngrihen çështje të procedurës në gjykimin në apel, apo kur është vetë dispozita procedurale ajo që vjen në ndihmë të zgjidhjes së çështjes në themel (shumica e vendimeve ka një analizë të detajuar të normës procedurale). Konkretisht:

- në vendimin civil nr. 2330/2013, referuar pretendimit të ankuesit mbi parregullsinë dhe njëanshmërinë e procesit gjyqësor në shkallë të parë, gjyqtarja vlerëson rëndësinë e procesit të rregullt gjyqësor, të vendimeve të arsyetuara, të debatit gjyqësor mes palëve në kuadër të kontradiktoritetit, të vendimit të mbështetur në prova dhe duke iu përgjigjur kërkesave të palëve duke analizuar kështu nenet 300, 28 dhe 20 të KPRC. Një interpretim të rëndësisë së procesit të rregullt ligjor dhe parimit të kontradiktoritetit e bën edhe në vendimin civil nr.37, datë 14.01.2016, por pa cituar normën procedurale.

- në vendimin civil nr. 2326, datë 01.11.2013 gjyqtarja konkludon që vendimi i shkallës së parë nuk përkon me shkakun ligjor për të cilin kërkuesi i është drejtuar gjykatës duke analizuar kështu procedurën e ndjekur por pa citur normën procedurale.

- në vendimin penal nr.1130, datë 29.07.2015 gjyqtarja analizon nenin 228 të K.Pr.Penale në lidhje me kushtet për t'iu nënshtruar masave të sigurimit personal, të cilat duhen të jenë kumulative dhe të nenit 253 në lidhje me kushtet që duhet të plotësohen që ndalimi të quhet i ligjshëm.

¹⁴ Vendimi nr.1132 datë 29.07.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

¹⁵Vendimi nr. 346, datë 11.03.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

- në vendimin penal nr. 1806, datë 27.10.2015 gjyqtarja analizon që deklarimi në mungesë i të pandehurit mbështetur në nein 351 të K.Pr.Penale është i gabuar sepse kjo dispozitë lejon gjykimin në mungesë kur plotësohen sëbashku kushtet e njoftimit të rregullt të të pandehurit dhe mungesës së rrethanave të ligjshme në mosparaqitje. Ky nen është analizuar së bashku me nenin 132 dhe 140 që lidhet me njoftimin dhe format e tij; analizon nenin 128/c në lidhje me pavlefshmërinë e akteve që lidhen me njoftimin e të pandehurit në ndërthuerje me nenin 428/ç.

- në vendimin penal nr. 1132, datë 29.07.2015 gjyqtarja analizon, në lidhje me njëri-tjetrin, nenet 221, 221/4/5, 222, 149, 151/4 të Kodit të Procedurës Penale në lidhje me rastet dhe kushtet e lejimit të përgjimit dhe konkludon që ligjvënësi vendos kritere shumë të forta sigurie dhe nuk mund të lejojë përgjimin pa asnjë provë tjetër. Ndërsa në vendimin nr. 346, datë 11.03.2015 interpreton në mënyrë të përgjithshme nenin 425 të K.Pr.Penale në lidhje me kufijtë e shqyrtimit të çështjes në apel.

- Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante:

Në disa prej vendimeve të analizuara, rezulton se gjyqtarja ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve në lidhje me interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij. Konkretisht në lidhje paanshmërinë e gjykatës dhe garantimin e barazisë së palëve gjyqtarja përmend qëndrimin e konsoliduar të praktikës së së Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut¹⁶. Ndërsa në vendimin me objekt “Shfuqizimin e vendimit të KQZ”¹⁷ gjyqtarja i referohet një sërë vendimesh të Gjykatës Kushtetuese si: vendimin nr. 5, datë 21.01.2011, vendimin nr. 26, datë 28.09.2010 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese, vendimin nr.25/2009, vendimin nr. 8, datë 08.03.2013, vendimin 31, datë 19.11.2003, vendimin nr. 25, datë 24.07.2009, vendimin nr. 31, datë 19.11.2003, vendimin nr. 29, datë 21.12.2006 dhe Kartën Evropiane të Vetëqeverisjes Vendore.

- Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës:

Gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, gjyqtarja përmend dhe zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet jo vetëm duke i përmendur ato shprehimisht, por edhe të nxjerra nga konteksti i arsytimit dhe konkluzionit të arritur. Evidentohet se gjyqtarja njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit siç janë: e drejta për t’u dëgjuar¹⁸¹⁹, për t’u mbrojtur²⁰, për t’u gjykuar nga një gjykatë e

¹⁶ Vendimi nr. 2330, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁷ Vendimi nr. 1, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁸ Vendimi nr. 1806, datë 27.10.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

¹⁹ Vendimi nr. 128, datë 21.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²⁰ po aty

paanshme²¹²², e drejta e palëve për akses²³, parimi i kontradiktorit²⁴. Gjyqtarja njih dhe zbaton parimet e së drejtës materiale të cilat i shërbejnë dhe i vijnë në ndihmë interpretimit të ligjit dhe zgjidhjes së çështjes në themel si: parimi i mirëbesimit²⁵, parimi i ushtrimit të sovranitetit nga populli²⁶ etj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe, kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësorë të Gjykatës Kushtetuese, të GJEDNJ, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës. Aftësia e gjyqtares spikat kryesisht në evidentimin rast pas rasti të parimit interpretues të normës sipas objektit, qëllimit rregullues, gjithmonë në drejtim të zgjidhjes së çështjes. Mënyra e interpretimit të nocioneve ligjore të padetajuara nga ligji apo të pazhvilluara nga praktika, i jep vlerë arsyetimit ligjor dhe e bën atë unik në vetvete.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Gjyqtari duhet të ketë në konsideratë se e tërë dija e tij profesionale do të ketë vlerë nëse vendimi i tij është hartuar në një gjuhë të thjeshtëzuar dhe të kuptueshme.

²¹ po aty

²² Vendimi nr. 2330, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²³ Vendimi nr. 1371, datë 09.04.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²⁴ Vendimi nr. 2330, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²⁵ Vendimi nr. 1038, datë 03.05.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë.

²⁶ Vendimi nr. 1, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë :

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore, përfundimtare, të arsyetuara prej saj janë të qarta dhe të kuptueshme, duke respektuar rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore.”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm jo vetëm për njohësit e ligjit, por edhe për një lexues të arsyeshëm,

Gjyqtarja, përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, fjalëve fyese apo denigruese. Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip (konstatohet gjithmonë përdorimi i shkronjës “ç” dhe “ë”. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjyqtarës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve, parimeve, apo të drejtave të pjesëmarrësve në një procedim civil dhe penal, nuk rezulton përdorimi i termave latine²⁷, por parimet apo institutet përdoren në gjuhën shqipe.

²⁷Është e diskutueshme nëse përdorimi i fjalëve në latinisht e rrisin apo jo vlerën e një vendimi gjyqësor, duke qenë se konsiderohet si “gjuhë e vdekur”, ndërkohë që vetë jurisprudenca ndërkombëtare kryesisht ajo e GJEDNJ-së shumë terma juridikë i përdor në gjuhën e vjetër latine. Pavarësisht këtij diskutimi, nëse do të konsiderohej vlerë, ajo do të duhej gjithmonë të shoqërohej me kuptimin e saj në gjuhën shqipe me qëllim që ky parim apo institut të bëhej i kuptueshëm edhe nga mosnjohësit e ligjit.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit. Mënyra e zgjedhjes dhe përdorimit të fjalëve siguron një balancim midis të shprehurit thjesht dhe konciz, me përdorimin e gjallë dhe të zhdërvjelltë të gjuhës shqipe.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRË ORGANIZUAR E VENDIMIT

Organizimi i arsyetimit ligjor duhet të përcaktojë nëse lexuesi i saj, do ta kuptojë dhe të bindet nga argumentet e përdorura nga gjyqtari. Nëse gjyqtari në dhënien e argumenteve ligjore nuk do të ndjekë një strukturë të qartë, shumë nga pikat kryesore të vendimit mund të humbasin apo mund të mos kuptohen drejt. Në këtë kontekst, është thelbësore që arsyetimi të ndjekë një format të qartë organizimi në funksion të orientimit të lexuesit dhe kuptueshmërisë së përmbajtjes së vendimit gjyqësor. Edhe pse nuk ka një unifikim në lidhje me mënyrën e strukturimit të një vendimi gjyqësor, e për pasojë i jep një liri gjyqtarit në strukturimin e tij, nga ana tjetër, referuar rregullave të shkrimit dhe arsyetimit ligjor, shkrimi ligjor ka strukturën e tij specifike që juristët/gjyqtarët duhet ta përdorin në një formë apo në një tjetër, dhe pavarësisht nëse ndiqet metoda IRAC (*Issue, Rule, Application, Conclusion*), CRAC (*Conclusion, Rule, Application, Conclusion*) etj, të gjitha këto metoda duhet të jenë në funksion të argumentimit ligjor të përdorur nga gjyqtari në zgjidhjen e çështjes, duke shtruar çështjen/ pyetjen për zgjidhje, normën relevante që do të duhet të zbatohet për zgjidhjen saj,

analizën e fakteve përkatëse në lidhje me çështjen e shtruar për zgjidhje dhe konkluzioni i arritur.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Struktura është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ndjek në hartimin e vendimit një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar, në përmbajtje të së cilës i përmbahet, si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të së cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi, përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në Apel.

Pjesa përshkuese – arsyetuese është e ndarë në disa nënpjesë, edhe pse vizualisht jo me tituj të përcaktuar si p.sh. “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “analiza juridike”, nga mënyra e pasqyrimin të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nëndarje. Në pjesën përshkruese analizohen në mënyrë të detajuar: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarit dhe konkluzionin e tij.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, si dhe data e shpalljes së

vendimit.

Vendimet gjyqësore përmbajnë të gjithë elementët e parashikuar në ligjin procedural, vendimet civile elementët e parashikuar në nenin 310 të K.Pr.Civile dhe nenit 466 të K.Pr.Civile dhe vendimet penale elementët e parashikuar në nenin 383 të K.Pr.Penale. Po kështu vendimet përgjithësisht janë të strukturuar në paragrafë (edhe duke i numërtuar) me qëllim që palët të kuptojnë konkluzionin dhe arsyetimin e gjykatës për çdo pretendim të ngritur në ankim, në funksion të vendimmarrjes përfundimtare.

Gjyqtarja ndjek rregulla të qarta në strukturimin e vendimit gjyqësor. Ajo zbaton rregullat e shkrimit ligjor duke identifikuar faktet, provat, argumentimin ligjor në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm, dhe konkluzionin e arritur.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirë organizuar të vendimit sipas pjesëve përbërëse të tij. Në të gjitha vendimet e analizuara, ndjekja e një strukturë të njëjtë, të mirë përcaktuar, të qartë dhe të ndërtuar mbi bazën e ecurisë logjike, nga njëri paragraf në tjetrin dhe nga njëra pjesë e vendimit në tjetrën, i bën vendimet lehtësisht të lexueshme dhe të kuptueshme dhe orienton drejt dhe saktë lexuesin lidhur me përmbajtjen e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Vendimet duhet të arsyetohen, përndryshe janë të pavlefshme. Arsyetimi i vendimit duhet të tregojë, zgjidhjet e të gjitha çështjeve procedurale dhe të thelbit/meritore, të së drejtës dhe të faktit, me të cilat është dashur të përballët gjyqtari, për të justifikuar vendimin e shprehur në dispozitiv. Konkluzioni i vërtetuar në dispozitiv të vendimit, duhet të arsyetohet, duke parashtruar procesin logjik, nëpërmjet të cilit është arritur tek bindja e formular. GjEDNj-ja është shprehur se, megjithëse gjykatave u lejohet një liri e konsiderueshme veprimi, përsa u përket strukturës dhe përmbajtjes, ato

janë të detyruara të shprehin me qartësinë e duhur arsyet mbi të cilat ato i mbështesin vendimet e tyre me qëllim që subjekti ta ushtrojë realisht të drejtën që ka për t'u ankuar.²⁸

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim*);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Përmbajtja e vendimit përfundimtar i jep përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Analiza ligjore është e thjeshtë, mjaftohet me tregimin e neneve ligjore të zbatueshme dhe me konkluzionin e zbatimit të tyre, duke përdorur fjali përgjithësuese.....”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në të gjitha vendimet gjyqësore të analizuara, rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithmonë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale, si në rastet kur ai përbën shkak ankimi ashtu edhe në rastet kur analiza e fakteve dhe dispozitave me natyrë procedurale është thelbësore për zgjidhjen e çështjes²⁹.

Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një organizim funksional dhe zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material penal, duke integruar qartë faktet me provat e administruara dhe interpretimin e ligjit me faktet e çështjes konkrete, duke orientuar më pas analizimin e faktit dhe ligjit më funksion të konkluzioneve mbi shkaqet e ankimit dhe zgjidhjen e çështjes në tërësi, për bazueshmërinë ose jo të secilit shkak ankimi. Evidentohet një kujdes i mirë i gjyqtarës për të identifikuar ligjin e zbatueshëm, duke i kushtuar vëmendjen e duhur kur është e nevojshme analizimit të ligjit dhe koncepteve ligjore në mënyrë abstrakte dhe në raport me çështjet konkrete në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes, referuar shkaqeve të ankimit.

Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe gjithmonë merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve të parashtruar në ankim nga pala ankuuese, gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse të parashtruara gjatë gjykimit në shkallë të parë.

²⁸ Vendimi i GjEDNJ, çështja Hadjanastassiou vs Greqisë, dt. 16.12.1992, fq. 33.

²⁹ Vendimi me nr.1912, datë 28.09.2016, vendimi nr.1130, datë 29.07.2015, vendimi me nr.2330, datë 04.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë etj.

Kështu, sa i përket përmbajtjes gjithëpërfshirëse në lidhje me marrjen në shqyrtim të pretendimeve të palëve, shkaqeve të ankimit, në të gjitha vendimet burim vlerësimi ato janë pjesë e integruar e vendimit gjyqësor, duke u pozicionuar në atë pjesë të arsytimit me të cilën lidhet pretendimi, (*me aspektet procedurale të gjykimit, marrjen e provave dhe mënyrën e marrjes së tyre, provueshmërinë e faktit, cilësimin ligjor të faktit penal apo civil etj.*) apo janë pjesë e analizës ligjore, duke u identifikuar në mënyrë të veçantë në fund të pjesës arsytuese. Duke u marrë në shqyrtim dhe analizuar, në disa raste si pjesë e arsytimit ligjor dhe në disa raste komplekse në një pjesë të veçantë të arsytimit (por në pjesën përkatëse të arsytimit që ka të bëjë pikërisht me pretendimin konkret), pretendimet e palëve të cilat lidhen me shkaqet e ankimit gjithnjë kanë marrë një përgjigje të argumentuar, në aspektin e mbështetjes në ligj ose prova të tyre, duke u integruar në mënyrë të natyrshme si pjesë e arsytimit tërësor.

Në të gjitha vendimet evidentohen edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të shprehur, ngritja e çështjeve për diskutim, duke ardhur e nënkuptuar nga analiza dhe arritja e përfundimit ligjor. Konstatohet identifikimi i teksit normativ (penal apo civil) kur është e nevojshme pa shkuar në përsëritje, duke cituar jo vetëm nenin përkatës por edhe atë që sanksionon ai, në funksion të analizimit të elementeve të figurës së veprës penale, të përcaktimit të natyrës së marrëdhënies juridike civile, elementëve përbërës të tij si dhe analizimin e saj në raport me faktet konkrete.

Në një pjesë të vendimeve burim vlerësimi, përveç analizës së provave dhe nxjerrjes së faktit juridik konkret, referuar shkaqeve të ankimit, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë, analizës së instituteve të caktuara të së drejtës apo konketeve të caktuara ligjore, kur kjo rezulton e nevojshme p.sh.: (i) Institutit juridik të shpërblimit të dëmit kontraktor³⁰; (ii) Institutit të hetimit të gjithanshëm³¹; (iii) Institutit të hetimit dhe gjykimit në mungesë, duke e lidhur me të drejtat e të pandehurit në procesin penal, që lidhen me pjesmarrjen, dëgjimin dhe mbrojtjen³²; (iv) instituti i shpërblimit të dëmit pasuror dhe jo pasuror³³, (v) konceptimin mbi elementet thelbësor të një kontrate shërbimi³⁴, (vi) padinë e kërkimit të sendit të përcaktuar në nenin 296 të Kodit Civil nga njëri bashkëpronar kundrejt tjetrit³⁵ etj.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik ndjek rregullin: fakt-normë-interpretim ligjor-konkluzion, duke krijuar një pamje të qartë të zhvillimit të mendimit juridik të gjyqtarës në mënyrën e organizimit dhe paraqitjes së procesit analitik dhe logjik të arsytimit. Në secilin vendim të analizuar, mendimi logjik ka vijueshmëri dhe evidentohet interpretimi individual i ligjit, si dhe mbështetja e tij në qëndrimet e praktikës gjyqësore, dhe integrimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës. Arsyetimi i vendimeve është i qartë,

³⁰Vendimi nr. 2297 datë 23.05.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³¹Vendimi nr.128 datë 21.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³² Vendimi nr. 1806, datë 27.10.2015 Gjykatës së Apelit Tiranë

³³ Vendimi nr. 2330, datë 04.11.2013 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³⁴ Vendimi nr.2297, datë 23.05.2014 i Gjykatës së Apelit Tiranë

³⁵ Vendimi nr.1058, datë 05.05.2016 i Gjykatës së Apelit Tiranë

i plotë dhe merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve të cilat janë objekt ankimi apo çështjeve të shtruara për diskutim kryesisht në aspektin procedural dhe thelbësor, me qëllim dhënien e një përgjigje të argumentuar në lidhje me mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “shumë e lartë” duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

Niveli i vlerësimit AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij si kur gjykon i vetëm ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në raportin analitik të rivlerësimit, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, nuk pasqyrohet asnjë analizë e burimeve lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave, ndër të cilët një është evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit në apel. Po kështu edhe për çështjet civile të themelit, në përgjithësi nuk parashikohet afat ligjor në Kodin e Procedurës Civile për përfundimin e tyre në gjykatën e apelit.

Ndërsa në nenin 157 të Kodit Zgjedhor, të miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar, përcaktohet se Kolegji zgjedhor gjykon dhe vendos për kërkesëpaditë brenda 10 ditëve nga depozitimi i kërkesëpadiës dhe në rastet e parashikuara nga fjalia e fundit e paragrafit të fundit e pikës 2 të nenit 152 të këtij Kodi, Kolegji Zgjedhor vendos brenda 30 ditëve nga depozitimi i ankimit³⁶.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja si dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave, referuar kategorisë së çështjeve, vetëm për 2³⁷ prej tyre parashikohet afat ligjor për shqyrtimin e çështjes në apel. Konkretisht:

(i) Vendimi 2 i zgjedhur nga gjyqtaria, që i përket vendimit nr.1130, datë 29.07.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë, «kërkesë penale në fazën e hetimeve paraprake» (*vleftësim ndalimi dhe caktim mase sigurimi*), për të cilën është parashikuar si afat ligjor afati 10 ditor nga marrja në dorëzim i akteve, sipas nenit 249 të K.Pr.Penale³⁸. Referuar vendimit të

³⁶ Në pikën e fundit të pikës 2 të nenit 152 të Kodit Zgjedhor, parashikohet se;” Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë.”

³⁷Vendimi nr. 1130, datë 29.07.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë, si dhe vendimi nr.1, datë 14.01.2015 i Kolegjit Zgjedhor, të zgjedhur nga gjyqtarja.

mësipërm, në kushtet kur nuk është administruar dosja dhe nuk ka të dhëna lidhur me datën kur aktet i janë dorëzuar gjyqtarës, rezulton se çështja është regjistruar në Gjykatën e Apelit në datë 24.07.2015 dhe vendimi është shpallur në datë 29.07.2015, pra brenda 5 ditëve nga dita e regjistrimit. **Kështu, rezulton se është respektuar afati 10 ditorë i parashikuar nga neni 249 pika 5 e K.Pr.Penale për përfundimin e saj.**

(iii) Vendimi 3 i zgjedhur nga gjyqtarja, që i përket vendimit nr.1, datë 14.01.2015 i Gjykatës së Apelit Tiranë (Kolegjit Zgjedhor), «ankim kundër vendimeve të Komisionit Qendror Zgjedhor», për të cilën është parashikuar si afat ligjor i shqyrtimit nga Kolegji Zgjedhor, afati 10 ditor nga depozitimi i kërkesëpadisë, sipas nenit 157 të Kodit Zgjedhor, të miratuar me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, të ndryshuar. Referuar vendimit të mëipërm, në kushtet kur nuk është administruar dosja dhe nuk ka të dhëna lidhur me datën që çështja i është shortuar gjyqtarës, rezulton se çështja është regjistruar në datë 16.12.2013 (data e shënuar në pjesën e parë të vendimit) dhe ka përfunduar në datë 14.01.2015, pra gjykimi nga kjo datë ka zgjatur 1 vit e 30 ditë. Por po t' i referohemi pjesës tjetër të vendimit, konkretisht objektit të saj rezulton se objekt i këtij ankimi janë vendimet e KQZ, datë 14.11.2014, 130 vendime të marra në këtë datë. Referuar, parashikimit ligjor të bërë në nenin 152 të Kodit Zgjedhor, i cili parashikon se:” Ankimet, sipas këtij Kodi, paraqiten në Gjykatën e Apelit, Tiranë, e cila ia kalon ato Kolegjit Zgjedhor. 2. Ankimi për të gjitha vendimet që KQZ-ja merr në periudhën, e cila fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundim të shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhje, bëhet brenda 5 ditëve nga shpallja e tyre. Për vendimet që KQZ-ja merr jashtë kësaj periudhe, afati i ankimit në Kolegjin Zgjedhor është 30 ditë », sipas të cilit rezulton se ndaj vendimit të KQZ të marrë gjatë periudhës zgjedhore, që fillon 48 orë pas dekretimit të zgjedhjeve të pjesshme ose të përgjithshme deri në përfundimin e shqyrtimit administrativ të ankimeve zgjedhore, ose të kalimit të afateve të ankimit për zgjedhjes, siç është rastin konkret, palët kanë të drejtën e ankimit brenda 5 ditëve nga shpallja e vendimit, rezulton se ndaj këtyre vendimeve, ankimi në apel është bërë rreth datës 19.11.2014. Sa më sipër, data e përcaktuar në pjesën hyrëse të vendimit, vlerësohet se nuk përcakton datën e saktë të regjistrimit të çështjes por kemi të bëjmë me një gabim material dhe data e saktë e regjistrimit të çështjes në apel mund të jetë edhe data 16.12.2014. Duke marrë të mireqenë këtë datë, si datë të depozitimit të ankimit në Gjykatën e Apelit, rezulton se deri në datën e dhënies së vendimit, datë 14.01.2015, gjykimi ka zgjatur rreth 1 muaj, pra jashtë afatit ligjore prej 10 ditësh.

Megjithatë, referuar përsëri përmbajtjes së vendimit, rezulton se në Gjykatën e Apelit janë paraqitur gjithësej 130 padi të ndryshme, me objekt ankimi 130 vendime të KQZ, me palë kërkuese/ ankuese një parti, dhe 131 subjekte të interesuara, ku në seancën gjyqësore të datës 08.01.2015 është vendosur bashkimi i tyre në një gjykim të vetëm, dhe më pas është caktuar seanca e rradhës për shqyrtimin e tyre në datë 14.01.2015, në përfundim të cilës është marrë vendimi.

Po t' i referohemi datës kur nga Kolegji është marrë vendimi për bashkimin e 130 padive në një çështje më vete, datë 08.01.2015, në kushtet kur nuk ka të dhëna për kohën e shortimit të çështjeve, relatorin përkatës, si dhe datën e marrjes së vendimit, **rezulton se gjykimi i çështjes në tërësi ka përfunduar brenda afatit 10 ditorë të përcaktuar në nenin 157 të Kodit Zgjedhor.**

Në dosje administrohet edhe vendimi gjyqësor që i përket çështjes me nr. regjistri 1206, datë regjistrimi 01.09.2014, përfunduar me vendimin nr. 642, datë 06.10.2014 me objekt “Lëshim i urdhërit të mbrojtjes”, për të cilën gjykimi ka përfunduar brenda një afati prej 1 muaj e 3 ditë nga dita e shortimit të saj datë 03.09.2014 . Por sipas ligjit nr. 9669 datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhënie familjare”, që ka qenë në fuqi në këtë kohë,

³⁸ Neni 249, pika 5 e Kodit të Procedurës Penal, përpara ndryshimeve të bërë me ligjin nr.35/2017, parshikonte; “5. Kërkesa shqyrtohet Brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim akteve.”

nuk parashikohet afat për përfundimin e saj në apel. Një parashikim i tillë është bërë vetëm me ligjin nr.48/2018, ku është parashikuar një afat prej 15 ditësh për përfundimin e çështjes në gjykatën e Apelit.

Gjithashtu burim vlerësimi është edhe dosja që i përket çështjes me nr.1145 regj, datë regjistrimi 24.07.2015, me objekt; ankim ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për lejim përgjimi, përfunduar me vendimin 29.07.2015, e cila ka përfunduar brenda një afati prej 5 ditëve nga dita e regjistrimit. Referuar pashikimeve të nenit 222 dhe 223 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi, në kohën e shqyrtimit të kësaj kërkesë, rezulton se për gjykimin e këtij ankimi në apel nuk ishte parashikuar afat ligjor. Afat ligjor prej 48 orëve për shqyrtimin e ankimit ndaj vendimit për refuzimin e kërkesës për lejimin e përgjimeve, është parashikuar vetëm me ligjin nr.35/2017, i cili ka ndryshuar Kodin e Procedurës Penale³⁹.

Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjeve të analizuara më sipër, në të cilat për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre dhe prej tyre një çështje ka përfunduar brenda afatit ligjor (10 ditore sipas nenit 249 pika 5, të K.Pr.Penale) ndërsa një çështje ka përfunduar tej afati ligjor 10 ditore të parashikuar nga neni 157 të Kodit Zgjedhor, duke iu referuar datës së regjistrimit e cila mendohet se ka qenë 16.12.2014, për sa kohë kur nuk ka të dhëna për kohën kur çështja i ka kaluar nga kryetari i Gjykatës së Apelit, Kolegjit Zgjedhor, për kohën kur çështja i ka kaluar për short gjyqtarës në cilësinë e relatores, si dhe për shqyrtimin e ndonjë kërkesë për përjashtim sipas nenit 154 të Kodit Zgjedhor, si dhe kohën që i është nevojitur Kolegjit për të kryer të gjitha veprimet procedurale sipas këtij neni, që ka të bëjë dhe me njoftimin efektiv të secilës palë pjesmarrëse.

Megjithatë, po të marrin në konsideratë datën kur nga ana e Kolegjit Zgjedhor është vendosur bashkimi i 130 padive në një çështje më vete, datë 08.01.2015 si dhe datën e dhënies së vendimit 14.01.2015 rezulton e provuar se padia nga ana e Kolegjit është shqyrtuar brenda afatit ligjor prej 10 ditësh, e për pasojë do të konsiderohet në afat.

Edhe nëse nuk do të merret në konsideratë ky afat, duke konsideruar natyrën komplekse të çështjes e cila është gjykuar tej afatit ligjor, e cila në fakt përbëhet nga 130 padi, pra 130 çështje, me 132 palë ndërgjyqëse gjithësej, zhvillimin e gjykimit me prezencë të palëve (të cilët duhet të njoftoheshin rregullisht), natyrën e kërtimeve, volumin e kërtimeve dhe numrit të çështjeve të ngritura për diskutim, veprimet procedurale dhe administrative për bashkimin e çështjeve, për aq sa rezultojnë nga përmbajtja e vendimit përfundimtar, si dhe në mungesë të akteve të dosjes gjyqësore, për të gjykuar

³⁹ Neni 222, pika 4 Kodit të Procedurës Penale, I ndryshuar me ligjin nr.35/2017, parashikon se:” Në rastet e parashikuara në paragrafët 1, 2 dhe 3, të këtij neni, gjykata merr vendim të arsyetuar në dhomë këshillimi, brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit. Kundër vendimit që refuzon kërkesën për përgjim mund të bëhet ankim i veçantë në gjykatën e apelit brenda 24 orëve. Gjykata e apelit shqyrton ankimin brenda 48 orëve nga marrja e akteve. Paraqitja e kërkesës për vleftësimin e përgjimit nuk shkakton ndërprerjen e ti.”

mbi veprimet e ndërmarra nga gjyqtarja për administrimin e çështjes, vlerësoj se kjo çështje duke qenë një çështje e vetme, nuk mund të konsiderohet si tregues i saktë dhe absolut mbi aftësinë e gjyqtares për respektimin e afateve ligjore. Duke konsideruar veprimet procedurale dhe kohën e kryerjes së tyre, lidhur me shqyrtimin e këtyre padive, kohën e nevojshme që i është dashur Kolegjit Zgjedhor për kryerjen e veprimeve paraprahe dhe përgatitore apo për shqyrtimin e kërkesave që mund të jenë paraqitur, sipas nenit 154 të Kodit Zgjedhor, respektimin e afateve procedurale të parashikuara nga ky nen për secilin veprim, numrin teje të lartë të vendimeve objekt ankimi si dhe të palëve ndërgjyqëse, vlerësoj se aftësitë e gjyqtares në lidhje me këtë tregues janë të larta dhe një çështje, për më tepër komplekse në kërkime, nuk mund të shërbeje e vetme si tregues për aftësinë e gjyqtares për respektimin e afateve ligjore.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjet e analizuara për të cilat ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i afateve ligjore” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi mbështetur në burimet e vlerësimit nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga analiza e pesë dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtarja {...} (nga data e shortit të çështjet penale dhe civile nga data e seancës së parë të caktuar nga kryetari i gjykatës) ka qenë në intervale kohore nga një ditë (shihni dosjen 38 nr. 4) deri në 1 muaj e 6 ditë (shihni dosjen nr. 1). Nga këto dy çështje civile janë gjykuar brenda afatit standard, 15 ditë dhe 26 ditë, sipas vendimit të KLD-së, (shihni dosjet nr. 3 dhe 5), ndërsa dosja penale 2 është gjykuar brenda 5 ditëve. Çështja që ka pasur kohëzgjatjen më të madhe të gjykimit, prej 1 muaj e 6 ditë ka qenë çështje penale themeli me objekt jo kompleks dhe në përfundim është disponuar me vendim themeli.”

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja dhe 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave, të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Për 11 nga çështjet e vëzhguara të zgjedhura me short, 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim, si dhe 2 vendime të administruara për shkak të ankesave, vetëm për 2 (dy) prej tyre parashikohet afat ligjor shqyrtimi, ndërsa për 14 çështje parashikohet standard minimal kohor sipas vendimit nr.261/2 të ish KLD-së⁴⁰.

Konkretisht, referuar burimeve të vlerësimit, konstatohet se:

- (i) Vendimi nr.1058, datë 05.05.2016, i Gjykatës së Apelit Tiranë, i Gjykatës Administrative të Apelit, me objekt të padisë: “*Lirim dorëzim sendi.*”, referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 30.10.2015 dhe datë përfundimi 05.05.2016, pra rezulton që çështja ka përfunduar brenda një afati prej **6 muaj e 5 ditë nga dita e regjistrimit, duke e tejkaluar afatit standard minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD për gjykimet civile në gjykatën e apelit vetëm me 5 ditë, afat që konsiderohet i papërfillshëm.** Për këtë çështje nuk ka të dhëna për kohën kur çështja i ka kaluar me short gjyqtares as për datën kur kryetari i gjykatës ka caktuar seancën gjyqësore, pasi sipas parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile në atë kohë, ka qenë kompetencë e tij caktimi i seancës gjyqësore. Në këto kushte, referuar të dhënave që kemi, rezulton se çështja ka përfunduar brenda 6 muajve nga dita e shortimit, **pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**

⁴⁰ Sipas vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “tandardi kohor i punës nënkupton realizimin nga gjyqtari të gjykimeve brenda një afati kohor maksimal nga data e caktimit të gjyqtarit të çështjes si me poshtë: g. Gjykimet penale në gjykatën e apelit, jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm, h. Gjykimet civile në gjykatën e apelit jo më tej se 6 muaj”

- (ii) Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 349, datë 11.03.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj të pandehurit B.C, akuzuar për veprën penale të “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 të Kodit Penal, rezulton të jetë regjistruar në datë 29.01.2015, dhe i është shortuar gjyqtares në datë 04.02.2015 dhe ka përfunduar në datë 11.03.2015, brenda një afati prej **1 muaj e 7 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.**
- (iii) Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 1132, datë 29.07.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, m kërkues prokuroria pranë gjykatës së rrethit gjyqësor, me objekt, ankim ndaj vendimit të refuzimit të kërkesës për lejim përgjimi, parashikuar nga neni 222 i Kodit të Procedurës Penale, rezulton të jetë regjistruar në datë 24.07.2015, dhe ka përfunduar në datë 29.07.2015, brenda një afati prej 5 ditësh, **pra brenda standardit minimal kohor prej 2 (dy) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “k” të vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (iv) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.2330, datë 04.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë paditëse S.H e palë të paditur shoqëria CMS, me objekt, marrëdhënie pune, rezulton të jetë regjistruar në datë 17.12.2012 dhe shortin e datës 20.12.2012 i është caktuar gjyqtares dhe ka përfunduar në datë 04.11.2013. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, sipas parashikimit të kësaj dispozite në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile viheshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë është caktuar në datë 09.10.2013 dhe më pas vendimi është dhënë në seancën e datës 04.11.2013. Pra duke llogaritur këto afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për **35 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (v) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 37, datë 14.01.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës H E, me objekt “Shpërblim dëmi”, rezulton të jetë regjistruar në datë 09.09.2014 dhe me shortin e datës 10.09.2014 i është caktuar gjyqtares E. Petri. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, sipas parashikimit të kësaj dispozite në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile viheshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë dhe e vetme është caktuar në datë 16.01.2016, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet së paku 10 ditë përpara seancës së parë gjyqësore. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për së paku 11 ditë, **pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.**
- (vi) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr. 2326, datë 01.11.2013 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë kërkuese N.Q me objekt “Lëshimin i dëshmisë së trashëgimisë ligjore.”, rezulton të jetë regjistruar në datë 18.03.2013 dhe me shortin e datës 20.03.2013 i është caktuar gjyqtares E. Petri. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, sipas parashikimit të kësaj dispozite në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile viheshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën

- e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë dhe e vetme është caktuar në datë 01.11.2013, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet së paku 10 ditë përpara caktimit të seancës së parë gjyqësore. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për së 11 ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 4 (katër) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “k” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (vii) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.2297, datë 23.05.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës shoqëria “Vodafone Albania” sha, me objekt, “Përmbushje detyrimi kontraktor”, rezulton të jetë regjistruar në datë 22.02.2013, dhe me shortin e datës 26.02.2013 i është caktuar gjyqtarës E.Petri. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile vireshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë dhe e vetme është caktuar në datë 16.01.2016, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet afati 10 ditorë minimal për caktimin e seancës gjyqësore. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për rreth 11 ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (viii) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.1371, datë 09.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me palë paditëse/kundërpaditur M.Z, palë e paditur/kundërpaditëse M.D me objekt të padisë; “Anullimin e vendimit të kryeregjistruesit të ZRPP” dhe objekt të kundërpadisë; “shfuqizim të vendimit të KKP”, është regjistruar në 11.01.2013 dhe me shortin e datës 17.01.2013 i është caktuar gjyqtarës E. Petri si relatore. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile vireshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë është caktuar në datë 17.01.2014, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet afati 10 ditorë minimal para caktimit të seancës deri në datën e dhënies së vendimit. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për rreth 3 muaj e 3 ditë ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (ix) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.128, datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës I.T, të paditur AKKP, me objekt; “Ndryshim vendimi të AKKP dhe njohje pronar”, është regjistruar në datë 22.02.2014 dhe me shortin e datës 26.02.2014 i është caktuar gjyqtarës E. Petri. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile vireshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit të palëve me shpallje, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë dhe e vetme është caktuar në datë 21.01.2015, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet afati 10 ditorë minimal para caktimit të seancës deri në datën e dhënies së vendimit. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se

gjykimi i çështjes ka përfunduar për rreth 11 ditë ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***

- (x) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.642, datë 06.10.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë⁴¹, me paditës A.D, të paditur A.D, me objekt; Lëshimi i urdhrit të mbrojtjes, është regjistruar në datë 01.09.2014 dhe me shortin e datës 03.09.2014 i është caktuar gjyqtarës E. Petri. Rezulton se çështja është shqyrtuar për 1 muaj e 3 ditë nga dita e shortit, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (xi) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.1038, datë 03.05.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës H.N, të paditur Drejtori e Përgjithshme e Postës, me objekt, “dëmshpërblim për shkak të zgjidhjes së kontratës së punës”, është regjistruar në datë 17.12.2014 dhe me shortin e po kësaj date i është caktuar me short gjyqtarës E. Petri. Në dosje mungon akti i caktimit të seancës gjyqësore, pasi në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile viheshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit të palëve me shpallje, si dhe në kushtet kur nuk ka të dhëna për datën e shpalljes së listës së gjykimeve, dhe seanca e parë dhe e vetme është caktuar në datë 03.05.2016, si afat për gjykimin e saj do të llogaritet afati 10 ditorë minimal para datës së seancës gjyqësore. Pra duke llogaritur këtë afat, rezulton se gjykimi i çështjes ka përfunduar për rreth 11 ditë ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (xii) Çështja penale e përfunduar me vendimin nr. 1806, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, ndaj të pandehurit A.M, akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes”, parashikuar nga neni 134 i K. Penal, është regjistruar në datë 11.05.2015 dhe me shortin e datës 14.09.2015 çështja i është caktuar gjyqtarës E. Petri. Rezultoi se më datë 18.09.2015 çështja është vënë në lëvizje nga gjyqtarja, duke caktuar seancën e parë gjyqësore më datë 01.10.2015. Duke llogaritur afatin nga data e kalimit të çështjes në seancë gjyqësore deri në përfundim e saj me vendim, rezulton se çështja ka përfunduar për 1 muaj e 6 ditë, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në vendimin nr. 261/2 të KLD.***

Gjyqtarës {...} i janë evidentuar për efekt të vlerësimit profesional dhe etik dy vendime, si dhe gjatë procesit të vlerësimit janë administruar dy vendime për shkak të ankesave, të cilat i përkasin periudhës së vlerësimit, një prej të cilët është çështja që është evidentuar për efekt vlerësimi, konkretisht:

⁴¹ Ligji 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në familje” në vitin 2014 kur është dhënë ky vendim nuk parashikonte një afat ligjor për gjykimin në apel. Neni 21 i këtij ligji parashikonte se; “1. Kundër vendimit përkatës të gjykatës për nxjerrjen e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes mund të bëhet ankimi i veçantë në bazë të dispozitave të Kodit të Procedurës Civile. 2. Kundër vendimit për vërtetimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes ose kundër vendimit për nxjerrjen e urdhrit të mbrojtjes me vendim gjykatë mund të bëhet ankimi brenda afateve dhe rregullave të përcaktuara në dispozitat e Kodit të Procedurës Civile. 3. Paraqitja e ankimit nuk e pezullon ekzekutimin e vendimit të gjykatës për lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes apo të urdhrit të mbrojtjes.”

- (i) Çështja civile me nr. 4405/1799/39 regj., datë regjistrimi 05.08.2013, me paditës M.H, të paditur B.L, P.V, D.S etj, me objekt “Pushim cënimi”, e përfunduar me vendimin nr.1484, datë 15.06.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë. Sipas përmbajtjes së relacionit të Inspektoratit të KLD datë 07.10.2015, për shqyrtimin e ankesës nr.2701 prot., datë 10.08.2015, rezultoi se kjo çështje fillimisht i është caktuar gjyqtarës V.Hoxha dhe pas përjashtimit të dy anëtarëve të trupit gjykues, me shortin e datës 21.01.2015, çështja i është caktuar gjyqtarës E.Petri. Seanca e parë gjyqësore është caktuar në datë 26.02.2015 dhe gjykimi ka përfunduar me vendimin e datës 15.06.2015. Rezulton se gjykimi i kësaj çështje ka përfunduar brenda një afati prej 4 muaj e 25 ditë, në intervalin kohor 21.01.2015- 15.06.2015, duke u nisur nga dita shortimit të çështjes, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD.***
- (ii) Çështja civile e përfunduar me vendimin nr.1912, datë 28.09.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, me paditës/kundërpaditur K.Dh, të paditur/kundërpaditës P.D, me objekt padie,“pavlefshmëri absolute të veprimit juridik dhe rregullimin e pasojave të saj”, me objekt kundërpadie, “njohje pronar”, është regjistruar në datë 11.11.2015. Nuk ka të dhëna për kohën kur çështja është caktuar me short gjyqtarës E.Petri. Gjithashtu, nuk ka të dhëna për kohën ku çështja është caktuar në seancë gjyqësore nga kryetari i gjykatës, pasi në referim të parashikimeve të nenit 460/2 të K.Pr.Civile, në kohën e zhvillimit të gjykimit, çështjet civile viheshin në lëvizje nga kryetari i gjykatës dhe po ashtu caktohej prej tij seanca e parë gjyqësore, e cila duhet të caktohej jo më shpejt se 10 ditë nga dita e njoftimit të palëve me shpallje, do të prezumohet se çështja ka përfunduar brenda 6 muajve, referuar datës së regjistrimit të çështjes, ***pra brenda standardit minimal kohor prej 6 (gjashtë) muaj të parashikuar në pikën 5, germa “h” të vendimit nr. 261/2 të KLD***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, nga 14 çështjet për të cilat zbatohen standardet minimale kohore, sikundër rezultoi edhe më sipër, rezultoi se të gjitha çështjet kanë përfunduar brenda standardit minimale kohor, prej 2, 4 dhe 6 muajsh të përcaktuar në pikën 5 të vendimit nr. 261/2 të ish KLD-së. Pra në total: 100 % e çështjeve janë përfunduar brenda standardit minimal kohor, dhe 0 % jashtë standardit minimal kohor.

Sipas “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, të miratuar me vendimin me Nr. 264, datë 21.11.2019 të KLGJ, përqindja matematikore prej 0 % përkon me nivelin e vlerësimit 5 (pesë) pikë (0-10% - 5 pikë).

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar në të gjitha çështjet e analizuar.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi përqindja e çështjeve të gjykuara prej saj tej standardit minimal, është 0 %.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Në Raportin analitik të rivlerësimit nuk ka të dhëna apo konkluzione lidhur me këtë tregues.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve që trajtohen në gjykata e Apelit në periudhën e vlerësimit.

Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short, 1 vendim të përzgjedhur nga gjyqtarja për efekt vlerësimi (pasi 2 vendimet e përzgjedhura janë me afat ligjor) dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave, nga të cilat një është evidentuar gjithashtu për efekt të vlerësimit profesional dhe etik, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor dhe jo afati ligjor i gjykimit.⁴²

⁴² Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se :” Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi.”.

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (të analizuar në mënyrë të detajuar tek treguesi; *Plotësimi i standardeve minimale kohore*), rezulton se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 2 (dy) çështje në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezulton të jetë rreth 1 muaj e 6 ditë, *më e shkurtër se standardi minimal kohor 6 muaj, për gjykimin e çështjeve penale të themelit në gjykatën e apelit të cilat parashikojnë dënime deri në 10 vjet burgim, sipas vendimit të KLGJ nr.261/2.*
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “kërkesë penale- administrative”, rezulton të jetë rreth 5 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 2 muajsh, për gjykimin e kërkesave penale - administrative në Gjykatën e Apelit, sipas vendimit të KLGJ nr.261/2.*
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 8 (tetë) çështjet në kategorinë e çështjeve “civile themeli”, me palë kundërshtare rezulton të jetë rreth 87 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 6 (gjashtë) muajsh për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit, sipas vendimit të KLGJ nr.261/2.*
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështjet në kategorinë e çështjeve “kërkesë civile, pa palë kundërshtare”, rezulton të jetë rreth 11 ditë, *pra më e shkurtër se standardi minimal kohor prej 4 (katër) muajsh për gjykimin e këtyre çështjeve në Gjykatën e Apelit, sipas vendimit të KLGJ nr.261/2.*

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se koha mesatare që i dedikohet çdo çështje, për të gjitha kategoritë e çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor si dhe ka të dhëna burimore, ka qenë më e shkurtër se standardi minimal kohor.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “koha mesatare që i dedikohet çdo çështje” gjyqtarja pikëzohet me 5 pikë, pasi ajo është më e shkurtër se standardi minimal kohor.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;

Në Raportin analitik të rivlerësimit⁴³, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016 ka kryer detyrën e gjyqtarës në gjykatën e apelit Tiranë. Ajo ka deklaruar se për tre vitet e fundit të ushtrimit të detyrës i janë caktuar 1238 çështje dhe ka përfunduar si relatores 1051 çështje, duke mbartur vitin e fundit të ushtrimit të detyrës 10 çështje. Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit Tiranë, për efekte të organizimit të shortit konstatohet se për periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, gjyqtarja {...} për periudhën e rivlerësimit ajo ka gjykuar 1066 çështje gjyqësore, nga të cilat 675 civile të përgjithshme, 488 çështje civile me palë kundërshtare, 14 familjare, 132 civile pezullim/rivendosje, urdhëra mbrojtje 18 vendime dhe njohje vendimeve të huaja 30, çështje penale 377, nga të cilat penale themeli 55, kërkesa penale 7 dhe masa sigurimi personal 322”.*

Në këtë raport nuk rezulton të jetë llogaritur rendimenti i përfundimit të çështjeve për të gjithë periudhën e vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata e Apelit Tiranë të administruara në dosjen e rivlerësimit, si dhe formularit të vetvlerësimit profesional⁴⁴ (Shtojca 4) rezulton se gjyqtarja {...} për vitet 2014, 2015 dhe 2016 ka pasur këtë ngarkesë çështjes, të ndarë për çdo vit kalendarik.

- **Për vitin 2013 (08.10.2013-31.12.2013)**, gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 123 çështje, dhe nuk ka të dhëna për numrin e çështjeve të caktuara gjatë këtij viti;
- **Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014)**, gjyqtarës i janë caktuar për shqyrtim 472 çështje të reja, nga të cilat 421 çështje si gjyqtare në Gjykatën e Apelit, 50 çështje Gjykatën Administrative të Apelit dhe 1 çështje në Kolegjin Zgjedhor dhe ka përfunduar gjykimin për gjithsej 465 çështje. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 98.5 %.**
- **Për vitin 2015 (01.01.2015-31.12.2015)**, gjyqtarës i janë caktuar për shqyrtim 385 çështje të reja, nga të cilat; 379 çështje si gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe 6 çështje në Kolegjin Zgjedhor dhe ka përfunduar gjykimin për 256 çështje. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 66.5 %.**
- **Për vitin 2016 (01.01.2016-31.12.2016)**, gjyqtarës i janë caktuar 381 çështje të reja, nga të cilat, 380 çështje si gjyqtare në Gjykatën e Apelit dhe 1 çështje në Kolegjin Zgjedhor dhe ka përfunduar gjykimin për 253 çështje deri në datë 08.10.2016, ndërsa deri në fund të vitit 330 çështje. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 86.6 %.**

⁴³Raporti Nr.2867/4 prot., datë 03.07.2019 “Për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit”, faqe 572-573 të dosjes së rivlerësimit

⁴⁴ Faqe 5-11 të dosjes së rivlerësimit.

Në total për 3 vite të plota kalendarike për të cilat administrohen të dhëna për çështje të caktuara dhe ato të përfundura, rezulton se gjyqtarës i janë caktuar në total 1238 çështje dhe ka përfunduar me vendim deri në Dhjetor 2016, 1051 çështje. Rapori i çështjeve të përfunduara me atë të caktuara rezulton në masën e 84.9 %, rendiment i cili përkon me nivelin e pikëzimit me 4 pikë, sipas Metodologjisë së Pikëzimit.

Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, përcaktohet se: *“Të gjitha të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Analiza e të dhënave statistikore bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë se ai i tabelës së mësipërme, deri në pikëzim maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda të njëjtit vit kalendarik më shumë se 50 % të standardit minimal të ngarkesës së përcaktuar nga Këshilli.”*

Për aspektin sasior sipas pikës 3, gërma “h” të vendimit të ish KLD-së, nr. 261/2, datë 14.04.2010 “Sistemi i vlerësimit të gjyqtarëve” gjyqtari i Gjykatës së Apelit që është organizuar në dhomë penale, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 çështjesh penale (krime e kundërvajtje), i llogaritur në periudhën 3 vjeçare jo me pak se 450 çështje penale dhe gjyqtari i dhomës civile, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 200 çështje civile në vit, i llogaritur në periudhë 3 vjeçare, jo më pak se 600 çështje. Aneksi 1 i Sistemit të vlerësimit, në aspektin sasior nuk jep standarde minimale për gjyqtarin e gjykatës së apelit që nuk është organizuar në seksione. Në këto kushte, për analogji, edhe me standardet minimale të përcaktuara për gjyqtarin e shkallës së parë që nuk është organizuar në seksione, sipas përcaktimeve të Aneksit 1, do të merret si standard minimal 200 çështje themeli në vit (penale dhe civile).

Në lidhje me respektimin nga ana e gjyqtarës {...} të standardit sasior në fuqi, rezulton që gjyqtarja për periudhën 08.10.2013 - 08.10.2016⁴⁵, ka gjykuar gjithsej 1066 çështje, nga të cilat: 675 civile të përgjithshme, 14 familjare dhe 377 penale, nga të cilat 55 çështje penale themeli dhe 322 masa sigurimi personal. Gjyqtarja ka gjykuar dhe si e deleguar në Gjykatën e Apelit Administrativ, e cila ka gjykuar 50 çështje gjyqësore në vitin 2014, si dhe 7 çështje si relatore e Kolegjit Zgjedhor për vitin 2015- 2016. Kështu, në total, për këtë periudhë gjyqtarja ka gjykuar 1123 çështje. Nga të dhënat statistikore të përcjellë nga Gjykata e Apelit Tiranë, rezultojnë për çdo vit kalendarik, të dhënat e mëposhtme:

Për vitin 2013 (08.10.2013 - 31.12.2013), gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 123 çështje nga të cilat: 33 çështje civile, 1 çështje familjare, 16 çështje pezullim/rivendosje në afat, 2 çështje penale themeli, 5 çështje administrative dhe 66 çështje masa sigurimi.

⁴⁵ Sipas informacionit të përcjellë me shkresën nr. 5416 prot, datë 17.12.2018 të Gjykatës së Apelit Tiranë

Për vitin 2014 (01.01.2014 - 31.12.2014), gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 461 çështje nga të cilat: 221 çështje civile, 9 çështje njohje vendimesh të huaja, 4 çështje familjare, 56 çështje pezullim/rivendosje në afat, 7 çështje urdhër mbrojtjeje, 2 çështje administrative, 112 çështje masa sigurimi dhe 50 çështje si relatore e deleguar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë dhe 1 çështje në Kolegjin Zgjedhor.

Për vitin 2015 (01.01.2015 - 31.12.2015), gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 286 çështje nga të cilat: 130 çështje civile, 8 çështje njohje vendimesh të huaja, 3 çështje familjare, 19 çështje pezullim/rivendosje në afat, 7 çështje urdhër mbrojtjeje, 47 çështje penale themeli, 66 çështje masa sigurimi dhe 6 çështje gjyqësore zgjedhore.

Për vitin 2016 (01.01.2016 - 07.10.2016) gjyqtarja ka përfunduar gjithsej 253 çështje nga të cilat: 104 çështje civile, 13 çështje njohje vendimesh të huaja, 6 çështje familjare, 41 çështje pezullim/rivendosje në afat, 4 çështje urdhër mbrojtjeje, 6 çështje penale themeli, 78 çështje masa sigurimi dhe 1 çështje gjyqësore zgjedhore.

Pra referuar periudhës së vlerësimit rezulton se ajo ka gjykuar gjithësej 640 çështje themeli (penale dhe civile), duke e tejkaluar standardin minimal, me 40 çështje.

Sipas vërtetimit nr.371 prot., datë 27.0.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për vitin 2014, 2015 dhe 2016, gjyqtarja ka gjykuar gjithësej 993 dosje, nga të cilat, 414 çështje në vitin 2014, 250 çështje në vitin 2015 dhe 329 çështje në vitin 2016. Në vitin 2014 ajo ka gjykuar 50 dosje si relatore në Gjykatën e Apelit Administrativ dhe 8 çështje si relatore në Kolegjin Zgjedhor për vitin 2014, 2015 dhe 2016. Në total për 3 vite të plota kalendarike, 2014-2016 ajo ka gjykuar 1051 dosje dhe po ti shtojmë 123 dosjet të gjykuara nga data 08.10.2013- 31.12.2013, rezulton se ajo ka gjykuar 1174 çështje.

Veç ngarkesës si relatore, gjyqtari i gjykatës së apelit gjykon edhe në çështje si anëtare. Sipas të dhënave të dërguara nga Gjykata e Apelit, konkretisht për viti 2016, rezultoi se gjyqtarja {...} gjatë këtij viti është angazhuar si relatore në 329 çështje dhe si anëtare në 417 çështje.

Gjithashtu, sipas statistikave të Kolegjit Zgjedhor⁴⁶ rezulton se për gjatë vitit 2014-2016, gjyqtarja {...} ka përfunduar së gjykuari 8 çështje si relatore dhe 30 çështje si anëtare.

⁴⁶ Të përcjella me shkresën nr.371 prot.,d atë 27.01.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e vlerësimit është 84.9 %, përqindje e cila referuar metodologjisë së Pikëzimit pikëzohet me 4 pikë. Bazuar në Metodologjinë e Pikëzimit, sipas të ciliës të dhënat statistikore analizohen sipas situatës, me qëllim për të shmangur përfundimet për çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit, duke konsideruar (1) ngarkesën e përgjithshme në punë të gjyqtares, e cila rezulton se gjatë periudhës së vlerësimit të ketë përfunduar si relatore 1051 çështje, ose mesatarisht 350 çështje në vit; faktin se për të gjithë periudhën e vlerësimit, gjyqtarja e ka tejkaluar standardin minimale prej 600 çështjes, duke gjykuar 40 çështje më shumë; (iii) angazhimin e gjyqtares në plotësimin e trupave gjykues në gjykatën e apelit, pasi gjykimet zhvillohen me trup gjykues me tre gjyqtare, ku vetëm në vitin 2016, rezulton të jetë angazhuar në 417 çështje si anëtare, përveç 329 çështjeve si relatore;(iv) faktin se nxjerrja e çështjeve civile për gjykim në periudhën e vlerësimit, sipas nenit 460 të K.Pr.Civile ka qenë atribut i Kryetarit të Gjykatës; (v) angazhimin e gjyqtares në gjykimin si relator dhe anëtarë pranë Kolegjit Zgjedhor, në total në 38 çështje, të cilat paraqesin vështirë në gjykim, për të cilën Kodi Zgjedhor⁴⁷, në nenin 149 të tij ka parashikuar mundësinë e gjyqtarit për tu lehtësuar nga puna e tij e përditshme; (vi) angazhimin e gjyqtares në gjykimin e 50 çështjeve në Gjykatën Administrative të Apelit, vlerësohet se për këtë tregues gjyqtarja duhet të pikëzohet maksimalisht, me 10 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në sekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

⁴⁷ Neni 149 pika 2 e Kodit Zgjedhor parashikon se: “Me kërkesë të motivuar të gjyqtarit, Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi merr edhe mendimin e kryetarit të gjykatës, ku gjyqtari ushtron funksionin, vendos lehtësimin e ngarkesës së punës së tij.”

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);
- Informacioni i përcjellë nga gjykata⁴⁸ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.
- Dy vendimet për të cilat është bërë ankim dhe duhet t'i evidentohen gjyqtarës për efekt të vlerësimit etik dhe profesional.

Referuar Raportin analitik për analizimin e aftësive profesionale të KLGJ-së, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se: *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimet e 5 dosjeve të shortuara, rezultoi se arsyetimi i vendimeve është kryer në interval kohor nga 13 ditë (afati më i shkurtër - dosja nr. 5) gjer në 3 muaj e 6 ditë (afati më i gjatë - dosja nr. 3). Ndër 5 dosje të vëzhguara, 5 vendime janë arsyetuar jashtë afatit ligjor të parashikuar në ligjin e posaçëm (Shih dosjen nr. 1-5). Vendimi që është arsyetuar me vonesën prej 3 muajve e 6 ditë, ka qënë çështje civile themeli me të cilin është disponuar me vendim themeli për prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues”.*

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1 të K.Pr.Penale⁴⁹, në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr.35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, Kodi i Procedurës Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë⁵⁰ dhe nenit 476⁵¹ të Kodit të Procedurës Civile.

⁴⁸ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë nëpërmjet shkresës nr. 1633/1 prot, datë 21.03.2019 për 5 dosjet e përzgjedhura me short për vetting-un dhe me shkresës nr. 6161/1, datë 06.01.2021 për 6 dosjet e tjera për procesin e vlerësimit etik dhe profesional.

⁴⁹ Neni 35 pika 1 i K.Pr.P, para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, parashikonte se :” *Rekursi duhet të paraqitet me shkrim brenda tridhjetë ditëve nga data që vendimi ka marrë formën e prerë.*”

⁵⁰ Në nenin 443 të K.Pr.C parashikohet se:”*Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.*”

⁵¹ Neni 476 paragrafi i parë i K.Pr.C parashikon se:”*Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, në afatin prej 30 ditësh nga njoftimi që u është bërë palëve.*”

Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30/ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

- (i) Dosja 1, që i përket vendimit nr.346, datë 11.03.2015, është dorëzuar në sekretari në datën 09.04.2015- (pas 29 ditësh), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (ii) Dosja 2, që i përket vendimit nr.1132, datë 29.07.2015, është dorëzuar në sekretari në datë 03.09.2015 (1 muaj e 3 ditë), por duke zbritur muajin gusht, gjatë se cilit gjyqtarët dhe administrata gjyqësore kryen lejen e zakonshme, rezulton se çështja është dorëzuar pas 5 ditëve, brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (iii) Dosja 3, që i përket vendimit nr.2330, datë 04.11.2013, është dorëzuar në sekretari në datë 11.02.2014- (pra pas 3 muaj e 5 ditë, apo 96 ditë), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (iv) Dosja 4, që i përket vendimit nr.37, datë 14.01.2016, është dorëzuar në sekretari në datë 05.02.2016 -(pas 22 ditëve), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (v) Dosja 5, që i përket vendimit nr.2326, datë 01.11.2013, është dorëzuar në sekretari në datë 14.11.2013- (pas 13 ditëve), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë⁵², në datë 06.01.2021, lidhur me 6 dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 30.12.2020, rezulton se;

- (vi) Dosja 6, që i përket vendimit nr.2297, datë 23.05.2014, është dorëzuar në sekretari në datë 29.05.2014 – (pas 6 ditëve), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (vii) Dosja 7, që i përket vendimit nr.1371, datë 09.04.2014, është dorëzuar në sekretari në datë 21.05.2014 – (pas 1 muaj e 13 ditë, apo 43), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, duke e tejkaluar me 13 ditë.
- (viii) Dosja 8, që i përket vendimit nr.128, datë 21.01.2015, është dorëzuar në sekretari në datë 11.03.2015- (pas 1 muaj e 17 ditë, apo 47 ditëve), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (ix) Dosja 9, që i përket vendimit nr.642, datë 06.10.2014, është dorëzuar në sekretari në datë 18.11.2014 – (pas 1 muaj e 12 ditë, apo 42 ditëve), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, duke e tejkaluar me 12 ditë.
- (x) Dosja 10, që i përket vendimit nr.1038, datë 03.05.2016, është dorëzuar në sekretari në datë 25.07.2016 – (pas 2 muaj e 22 ditë ose 83 ditë), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.
- (xi) Dosja 11, që i përket vendimit nr.1806, datë 27.10.2015, është dorëzuar në sekretari në datë 25.11.2015- (pas 28 ditëve), brenda afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit.

Gjyqtarës {...} i janë administruar 2 vendime për shkak të ankesave që i përkasin periudhës së vlerësimit, 1 prej të cilave është evidentuar edhe për efekt të vlerësimit profesional dhe etik, ndërsa për një nuk ka të dhëna për kohën e dorëzimit të dosjes në sekretari, nga ku konstatohet se;

⁵² Informacioni I dërguar nga Gjykata e Apelit Tiranë me shkresën nr.6161/1 pot., datë 06.01.2021.

(xii) Çështja civile, që i përket vendimit nr.1484, datë 15.06.2015, me palë paditëse M.H, me objekt “Pushim i cënimit” është dorëzuar në sekretari në datë 16.07.2015- (pra pas 1 muaji e 1 ditë), jashtë afatit 30 ditor për ushtrimin e rekursit, duke e tejkaluar atë me një ditë, afat i cili është i papërfillshëm.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se: Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë;

- (i) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë *penale krime*, për 2 dosje (konkretisht dosja 1 dhe dosja 11) është 28.5 ditë.
- (ii) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë *civile themeli*, për 7 dosje, është 46.8 ditë.
- (iii) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë *kërkesa penale*, për 1 dosje (konkretisht dosja 2) është 5 ditë.
- (iv) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë *kërkesa civile*, për 1 dosje (konkretisht dosja 5) është 13 ditë
- (v) Koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategoritë *Jështje familjare/urdhër mbrojtje*, për 1 dosje (konkretisht dosja 9) është 42 ditë.

Referuar 3 vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja, konstatohet se nuk ka të dhëna për datën kur janë depozituar dosjet në sekretari, në kushtet kur janë administruar vetëm kopje të vendimit e për këto arsye, ata nuk do të jenë pjesë e llogaritjes.

KONKLUZIONI

Në tërësi referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar kujdes për arsyetimin e vendimeve në një kohë të shpejtë, e matur kjo kohë, rezulton më e shkurtër se afati 30/ditor për 3 kategori çështjesh dhe më e lartë për dy kategori, çështjet që i përkasin kategorisë civile themeli. Referuar Metodologjisë, kur koha e arsyetimit është më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve, i korespondon pikëzimit me 12 pikë.

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%.

Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve ku rezultoi se për një periudhë tre vjeçare (2014-2016), konkretisht deri në përfundim të vitit 2016, gjyqtarja ka dhënë 1051 vendime, mesatarisht rreth 350 vendime në vit, nga të cilat, 8 vendime të dhëna në Kolegjin Zgjedhor të cilat për shkak të natyrës janë komplekse (ku vetën në një nga vendimet e zgjedhura nga gjyqtarja rezulton se janë shqyrtuar 130 kërkime), pra rreth 31.85 vendime në muaj, dhe mesatarisht 1.5 vendime në ditë, referuar ditëve mesatare të punës në një muaj prej 21 ditësh, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, konkretisht kohën angazhimit të gjyqtares në gjykimet si anëtare e trupit gjykues, kur vetëm për

vitin 2016 për të cilën ka të dhëna, rezulton të ketë marrë pjesë si anëtare në 417 çështje, caktimin e saj për të gjykuar në 50 çështje administrative gjatë vitit 2014, propozohet që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, kjo duke pasur parasysh se vlerësuesi nuk mund të vlerësojë aftësinë e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues tej rritjes së pikëzimit me vetëm 1 shkallë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, vlerësohet se shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” të konsiderohet “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale hartuar nga KLGJ, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Subjektii rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në 3 prej dosjeve të vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë, të cilat kanë qenë produktive (Shih dosjet nr. 1,2 dhe 4); në 2 raste, gjykimi ka përfunduar me 3 seanca, 1 produktive dhe 2 joproduktive (shih dosjen nr.3 dhe 5). Këto të dhëna tregojnë se nga 8 seanca gjyqësore të vëzhguara, 5 prej tyre kanë qenë produktive. Shkak për dështimin e 4 seancave joproduktive ka qenë kërkesa e palëve(dhe mbrojtësve) për tu njohur me provat shkresore apo mosparaqitja e paleve. Ajo ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore penale(ato civile caktohen nga kryetari gjykatës), ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve pa vonesë nga sekretaria gjyqësore, ndonëse duhet t'i

dokumentojë më mirë veprimet e kryera. Nga 8 seanca gjyqësore gjyqësore 3 prej tyre kanë filluar me vonesë(shih dosjet nr 3 dhe 5) në të cilat nuk citohet shkaku i vonesës (shih dosjen nr,3 dhe 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit në lidhje me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, 9 çështje vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit dhe 2 çështje që i takojnë kategorisë kërkesa penale/civile (dosja 1 dhe 5).

Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 1, që i përket çështjes penale nr.1612 regj. Them, datë regjistrimi 29.01.2015, kundër të pandehurit BC, akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, e përfunduar vendimit nr.346, datë 11.03.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila rezulton të jetë produktive duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 3, që i përket çështjes civile me nr.8962 regj., datë 05.03.2015, me objekt Shpërblimin e dëmit që vjen nga zgjidhja e kontratës së punës”, përfunduar me vendimin nr.2330, datë 04.11.2013, rezulton se për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 3 seanca gjyqësore, nga të cilat 2 kanë qenë jo produktive, të cilat janë shtyre për arsye procedural, konkretisht 1 është shtyrë me kërkesë të paditëses për arsye të përligjura, ndërsa 1 seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues (mungesës së një anëtarit për shkaqe të përligjura) dhe 1 seanca ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 4, që i përket çështjes civile nr.134 regj., datë regjistrimi 09.09.2014, me objekt “Shpërblim dëmi nga vdekja e një familjari”, përfunduar me vendimit nr.37, datë 14.01.2016, rezulton se për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila rezulton të jetë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 (1), që i përket çështjes civile me nr. 2719/471 regjistri, datë regjistrimi 22.02.2013 me objekt « Përmbushje e detyrimit kontraktor », përfunduar me vendimin nr. 2297, datë 23.05.2014, të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes është zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 7 (2), që i përket çështje civile me nr. 1874/46 regjistri, datë regjistrimi 11.01.2013 me objekt padie “Anullim i aktit administrativ, vendimit të kryeregjistruesit », objekt kundërpadie « shfuqizim vendimit të KKP«, përfunduar me vendimin nr. 1371, datë 09.04.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 seanca nuk kanë qenë produktive, por janë shtyre gjithmonë për arsye procedurale, të cilat e kanë bërë të pamundur vijimin e gjykimit, konkretisht 1 seancë është shtyre me kërkesë të palës për tu garantuar përfaqësimi me avokat, 2 seanca me kërkesë të përfaqësuesit të palës për shkak të pamundësisë për tu paraqitur në seancë dhe kërkesës për tu njohur me provat, një seancë për shkak të mosnjoftimit rregullisht të palëve, ndërsa 1 seancë ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

- Dosja 8 (3), që i përket çështjes civile me nr. 3603/212 regjistri, datë regjistrimi 22.02.2014, me objekt « ndryshim vendimi të AKKP, njohje pronar », përfunduar me vendimin nr. 128 datë 21.01.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 9 (4), që i përket çështjes civile me nr.1206 regjistri, datë regjistrimi 01.09.2014, me objekt “Lëshim i urdhërit të mbrojtjes”, përfunduar me vendimin nr. 642 datë 06.10.2014 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 10 (5), që i përket çështjes civile me nr.6463/2437/280 regjistri, datë regjistrimi 17.12.2014, me objekt “Dëmshpërblim page”, përfunduar me vendimin nr. 1038 datë 03.05.2016 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se përfundimin e çështjes është zhvilluar vetëm 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 11 (6), që i përket çështjes penale me nr. 2411 regjistri, datë regjistrimi 11.05.2015, ndaj të pandehurit Armando Meçe, akuzuar për veprën penale të “Vjedhjes”, përfunduar me vendimin nr.1806, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë, rezulton se për përfundimin e çështjes janë zhvilluar gjithsej 3 (tre) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 kanë qenë joproduktive, të shtyre për arsye procedurale, konkretisht 1 për shkak të mosnjoftimit të të pandehurit dhe 1 për mosformim të trupit gjykues, ndërsa 1 seancë ka qenë produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja në 9 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli dhe civile themeli dhe familjare) varion nga 1 deri në 3 seanca gjyqësore dhe vetëm në 1 raste janë zhvilluar 5 seanca gjyqësore, e cila është shtyre kryesisht me kërkesë të palëve dhe për arsye procedurale, siç është mosnjoftimi i palëve, kërkesa e palës për shtyrje për arsye të përligjura, për tu njohur me aktet provuese të paraqitur në kuadër të një kërkesë për pezullimin e gjykimit, si dhe për shkak të mosformimit të trupit gjykues (mungesës së një anëtari tjetër për arsye të përligjura). Janë zhvilluar në total 17 seanca për 9 çështje.

Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë **1.8** seanca gjyqësore.

Nga vëzhgimi i dosjeve të çështjeve të përzgjedhura (çështje civile dhe penale themeli me palë) me short për vlerësim, rezulton se gjyqtarja ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (neni 460 të K.Pr.Civile dhe neni 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, përgjithësisht nuk konstatohet mungesa e njoftimeve për palët në dosje (*me përjashtim të njoftimeve të cilat janë bërë me shpallje konform dispozitave procedurale në lidhje me njoftimet në gjykimin në Apel, të cilat nuk janë administruar në dosje*) dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosformimit të trupit gjykues, por edhe në rastet kur seanca është shtyre për arsye procedurale, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit, me qëllim përfundimin e tyre brenda një afati të shkurtër kohor. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të

tilla si njoftimit i të pandehurit, njoftimi i palëve, kërkesat e palëve për tu njohur me aktet, apo kërkesat për shtyrje për shkak të mosparaqitjes së tyre për arsye të përligjura. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.P, përveçse kur kjo ka qenë objektivist e pamundur.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve⁵³ të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore për çështjet me palë kundërshtare është 1.8 seanca, dhe po kështu gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave jo produktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, duke qenë se numri mesatar i seancave gjyqësore në dosjet e analizuara është më i vogël se 3 si dhe shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, ajo duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “numri mesatar i seancave për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

⁵³ Referuar Metodologjisë së Pikëzimit “Për të pikëzuar këtë tregues vlerësuesi përcakton fillimisht numrin mesatar të seancave gjyqësore për çdo kategori çështjesh (civile, administrative, penale, dhe sipas shkallëve të gjykimin), duke përjashtuar ato pa palë ndërgjyqëse”.

Referuar Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Në 3 prej dosjeve të vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë të cilat kanë qenë produktive (shih dosjet nr. 1,2 dhe 40; në 2 raste, gjykimi ka përfunduar me 3 seanca, 1 produktive dhe 2 joproduktive (shih dosjen nr. 3 dhe 5). Këto të dhëna tregojnë se nga 8 seanca gjyqësore të vëzhguara, 5 prej tyre kanë qenë produktive. Shkak për dështimin e 4 seancave joproduktive ka qenë kërkesa e palëve (dhe mbrojtësve) për t’u njohur me provat shkresore apo mosparaqitja e palëve. Ajo ka kryer veprimet e nevojshme për caktimin e seancës gjyqësore penale (ato civile caktohen nga kryetari i gjykatës), ka mbikëqyrur kryerjen e njoftimeve pa vonesë nga sekretaria gjyqësore, ndonëse duhet t’i dokumentojë më mirë veprimet e kryera. Nga 8 seanca gjyqësore, 3 prej tyre kanë filluar me vonesë (shih dosjet nr 3 dhe 5) në të cilat nuk citohet shkak i vonesës (shih dosjen nr. 3 dhe 5)”*

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 9 prej tyre janë me palë kundërshtarë, 2 prej të cilave i përkasin kategorisë “*penale krime*”, 6 çështje i përkasin kategorisë “*civile me palë kundërshtarë*”, 1 çështje i përket kategorisë “*familjare me palë kundërshtarë (urdhër mbrojtje)*”, ndërsa 2 çështjet e tjera janë pa palë kundërshtarë, nga të cilat 1 çështje i përket kategorisë së kërkesave penale të hetimit paraprak dhe 1 kërkesë civile.

Tek çështjet penale, dokumentohet kryerja e veprimeve paraprake të gjykimin në përputhje me nenin 426 të K.Pr.Penale, vënia në lëvizje dhe nxjerrja e çështjes për gjykim, është bërë nëpërmjet urdhërimit nga gjyqtarja në cilësinë e relatores, të caktimit të datës së zhvillimit të seancës gjyqësore dhe njoftimit të palëve. Rezulton se çështjet janë vënë në lëvizje duke u nxjerr për gjykim në një afat të shkurtër nga dita e shortit. Ndërsa në çështjet civile, nuk evidentohen veprimet paraprake të kryera në gjyqtarja me qëllim nxjerrjen e çështjes për gjykim e datën e caktimit të seancës gjyqësore. Kjo sepse neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve me Ligjin 38/2017 parashikonte se: “...2. Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimin. 3. Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”.

Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës gjyqësore, të mbajtur me regjistrim audio si dhe të dokumentuara shkurtimit me shënimet e mbajtura nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale) kur është gjykuar si shkallë e dytë mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimin, gjyqtarja tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të

mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, apo palëve të cilat nuk janë paraqitur në seancë, megjithëse kanë pasur dijeni rregullisht, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore duke pasqyruar shkakun në çdo rast si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme të cilat janë të shoqëruara me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosje të vëzhguara, seancat e para gjyqësore të planifikuara për çështjet civile përgjithësisht janë çelur përgjithësisht me vonesë, por asnjëherë nuk kanë sjellë pasoja për zhvillimin e gjykimit. Përgjithësisht seancat gjyqësore kanë nisur me vonesë, si kur kanë qenë seanca të para (të planifikuara nga kryetari i Gjykatës) ashtu edhe kur kanë qenë seanca pasuese, planifikimi i të cilave nuk ka qenë përgjegjesi e gjyqtarit por e Kryetarit të Gjykatës. Në gjykimin në apel vonesa të tilla janë të përligjura për shkak të gjykimit me trup gjykues dhe angazhimit të gjyqtarëve në gjykimet të tjera. Seanca janë lënë përgjithësisht afër njëra tjetrës, jo vetëm në çështjet penale, por edhe në ato civile.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit kur ajo e ka pasur këtë të drejtë, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Referuar Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyruar saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në 5 dosjet e vëzhguara mangësitë janë të njëjta: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore, ka akte për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, në fashikull nuk përfshihet kopje e listës së shpalljes së seancave gjyqësore për të dokumentuar datën e njoftimit, ndonëse asnjë seancë nuk ka dështuar për këtë shkak; në fashikull nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për caktimin e datës dhe të orës së seancës gjyqësore. Procesverbali gjyqësor i plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Nga 5 dosjet gjyqësore janë inventarizuar aktet procedurale në 4 dosje (shih dosjen nr. 1,2,3 dhe 5)”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të doses rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*provat e administruara për herë të parë në gjykimi në Apel, aktet e përfaqësimit, kërkesat me shkrim, parashtrimet dhe diskutimet përfundimtare të palëve*). Sa i përket vendimit për caktimin e seancës së parë gjyqësore, sikurse konstatohet në raportin analitik të rivlerësimit si dhe nga vëzhgimi i gjashtë dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, pas fillimit të procedurës së vlerësimit, në të gjitha dosjet nuk ka një vendim formal (të shkruar) për caktimin e seancës së parë gjyqësore. Në lidhje me mungesën e përfshirjes në dosje të vendimeve të caktimit të seancës gjyqësore në çështjet civile, kjo nuk ka qenë detyrim i gjyqtrit relator, pasi sipas nenit 460 të K.Pr.Civile⁵⁴, para ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, caktimi i ditës së gjykimit bëhej nga Kryetari i Gjykatës. Ishte ky i fundit që përcaktonte çështjet gjyqësore që do të shqyrtoheshin nga secili trup

⁵⁴ Neni 460 i K.Pr.Civile para ndryshimeve me ligjin nr.38/2017 parashikonte:”... 2. *Kryetari i gjykatës së apelit cakton relatorin e çështjes dhe ditën e gjykimit*. 3. *Sekretaria e gjykatës së apelit i njofton palët rregullisht (nenet 128-133) të paktën 10 ditë më parë, ditën e shqyrtimit të çështjes në apel, si dhe shpall listën përkatëse të çështjeve”*.

gjykues në Apel dhe urdhëronte sekretarinë gjyqësore për njoftimin me shpallje. Në çështjet penale, neni 426, pika 1 i K.Pr.Penale⁵⁵ parashikon si kompetencë të gjyqtarit kryesues urdhërimin për thirrjen e palëve, por nuk përcakton mënyrën e dokumentimit të këtij urdhërimi nëpërmjet një akti formal (urdhër, vendim i shkruar) apo nëpërmjet njoftimeve. Pavarësisht mungesës së aktit formal në disa dosje, rezulton se kjo nuk ka sjellë në asnjë rast pasoja në zhvillimin e gjykimit, pasi urdhërimi për thirrjen e palëve në seancën e parë gjyqësore, është dokumentuar dhe realizuar nëpërmjet akteve të njoftimit dhe nuk rezultojnë seanca të dështuara për këtë shkak.

Në lidhje me konstatimin e raportit analitik të rivlerësimit se aktet e njoftimit të palëve nuk përfshihen rregullisht në dosje, konkretisht ka mungesë të shpalljes, pasi njoftimet e tjera janë, fakt i konstatuar edhe nga vëzhgimet e 11 dosjeve të përzgjedhura me short. Këto akte njoftimi të urdhëruara nga kryetari i gjykatës në ushtrim të kompetencës së tij për caktimin e seancës së parë gjyqësore në referim të nenit 460 të K.Pr.Civile nuk janë përfshirë në dosje pasi janë akte që nuk hartohen nga gjyqtari relator. Megjithatë, duhet theksuar se asnjë seancë gjyqësore në këto çështje nuk rezulton të ketë dështuar për shkak të mungesës së njoftimeve në dosje. Ndërkohë që në çështjet penale⁵⁶, aktet e njoftimit për seancën e parë dhe për seancat vijuese, rezultojnë të administruara rregullisht në dosjen gjyqësore.

Në lidhje me konstatimin e raportit analitik të vlerësimit se “*nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes*”, nga vëzhgimi i 11 dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton të jetë përfshirë në to relatimi me shkrim i gjyqtarit kryesues, por në çdo përmbledhje të procesverbalit të seancës gjyqësore, referohet si hap procedural, para referimit të vendimarrjes së gjykatës së shkallës së parë objekti i ankimit dhe relatimi i gjyqtarit për çështjen dhe shkaqet e ankimit. Referuar legjislacionit procedural në fuqi në kohën e zhvillimit të gjykimeve konkrete, nuk parashikohet në mënyrë të shprehur detyrimi për përgatitjen e relatimit të çështjes në formë të shkruar. Për pasojë mungesa e një relacioni me shkrim në aktet e dosjeve të shqyrtuara, në kushtet kur formalizimi i këtij akti në formë të shkruar nuk parashikohet shprehimit nga ligji, nuk mund të vlerësohet si mangësi në aspektin e aftësive organizative të gjyqtarit, dhe posaçërisht, në drejti të pikëzimit të treguesve të rregullshmërisë dhe plotësisë së dokumentacionit të dosjes.

Sa i përket rregullshmërisë së renditjes, në të gjitha dosjet e zgjedhura me short, konstatohet se aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht, të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (sipas datës së aktit) brenda së njëjtës kategori. Renditja e akteve i bën dosjet gjyqësore lehtësisht të aksesueshme duke

⁵⁵ Neni 426 pika 1 i K.Pr.Penale, para ndryshimeve me ligjin nr.37/2017, parashikonte :” *Kryetari i Kolegjit të gjykatës së apelit urdhëron thirrjen e të pandehurit, paditësit civil dhe të paditurit civil si dhe të mbrojtësve e të përfaqësuesve të tyre. Afati I paraqitjes nuk mund të jetë më I vogël se dhjetë ditë*”.

⁵⁶ Dosja që i përket vendimit nr.346, datë 11.03.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dosja që i përket vendimit nr.1806, datë 27.10.2015 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

përmbajtur aktin e shortit, njoftimet në rend kronologjik, procesverbalet e seancave sipas datave, diskutimet me shkrim të palëve dhe vendimin përfundimtar të gjykatës.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (njoftimet, shkresat, procesverbalet e seancave). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëruara dhe mund të shfrytëzohen pa asnjë vështirësi.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtara ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Referuar Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me këtë tregues, konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikqyruar saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Në 5 dosjet e vëzhguara mangësitë janë të njëjta: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore, ka akte për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, në fashikkul nuk përfshihet kopje e listës së shpalljes së seancave gjyqësore për të dokumentuar

datën e njoftimit, ndonëse asnjë seancë nuk ka dështuar për këtë shkak; në fashikull nu ka akt formal të gjyqtarit relator për caktimin e datës dhe të orës së seancës gjyqësore. Procesverbali gjyqësor i plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Nga 5 dosjet gjyqësore janë inventarizuar aktet procedurale në 4 dosje (shih dosjen nr. 1,2,3 dhe 5)”

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen thuajse të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (*njoftimet për çdo veprim apo seancë, procesverbalet e çdo seance, shkresat drejtuar institucioneve ndihmëse, vendimet gjyqësore*) si dhe aktet e paraqitura nga palët (*provat e administruara për herë te parë ne gjykimin në Apel, ankimi, parashtrimet dhe diskutimet përfundimtare të palëve kur janë paraqitur*). Nuk konstatohet prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

Gjithsesi dosjet kanë disa mangësi. Në dosje mungon akti formal i gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore, mungon relacioni me shkrim nga relatori i çështjes, si edhe përgjithësisht mungon një kopje e listës së shpalljes.

Në lidhje me mungesën e përfshirjes në dosje të vendimeve të caktimit të seancave gjyqësore në çështjet civile, kjo nuk ka qenë detyrim i gjyqtarit relator, sepse sipas nenit 460 të K.Pr.Civile para ndryshimeve me Ligjin 38/2017, caktimi i ditës së gjykimit bëhej nga Kryetari i Gjykatës. Ishte ky i fundit që përcaktonte çështjet gjyqësore që do të shqyrtoheshin nga secili trup gjykues në Apel, dhe urdhëronte sekretarinë gjyqësore për njoftimin me shpallje.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi në rastet kur evidentohet mungesa e aktit procedural për nxjerrjen e çështjeve civile për gjykim, kjo nuk ka qenë detyrë e gjyqtarit relator, por e Kryetarit të Gjykatës. Gjithsesi kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e gjykimit dhe përfundimin e tij, pasi në cilësinë e relatores gjyqtarja ka marrë të gjitha masat për mbikqyrjen e njoftimit të palëve për seancën e parë gjyqësore nga ana e sekretarisë gjyqësore. Për çdo gjykim civil në Apel gjyqtarja ka verifikuar njoftimet me shpallje si kur palët kanë qenë prezent ashtu edhe kur ato nuk janë paraqitur, duke relatuar këtë fakt në seancë gjyqësore. Asnjë veprim apo mosveprim nga ana e saj nuk ka ndikuar në mos zhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” vlerësohet “Shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për shumicën e treguesve të këtij kriteri bëhet në rend zbritës dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar treguesit përkatës, duke zbritur sipas rastiit pikët, në varësi të rezultateve të analizës objektive të të dhënave të burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: *“Duke evidentuar se përgjatë periduhës së rivlerësimit, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithësej 6 ankesa, 1 në vitin 2013, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016, në Inspektoriatin e KLDS-ë. Prej tyre 4 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhjen përmes apelimit gjyqësor. 2 ankesa janë verifikuar, 2 ankesa për zvarritje*

gjkimi i janë regjistruar gjyqtarës për efekt të vlerësimit profesional dhe etik. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedi, dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën e gjyqtarit.”

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk janë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionet e hartuara nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytje, ndjeshmërie, vëmendje apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 262, datë 17.06.2020, rezulton se Inspektorati i KLD-së ka përfunduar hetimin disiplinor për mosrespektim formal të ligjit duke konkluduar se ka pasur vonesa të dukshme në dorëzimin e vendimeve gjyqësore, të arsyetuara, duke sjellë kështu mosrespektimin formal të ligjit procedural në këtë drejtim nga subjekti. Inspektorati ka çmuar që rezultatet e hetimit disiplinor t’i përcillen Këshillit të Lartë Gjyqësor, në momentin e krijimit të tij në kuadër të vlerësimit etiko-profesional të subjektit për t’u evidentuar si një e dhënë statistikore në këtë vlerësim, pasi shkelja nuk rezulton të ketë qenë e kryer me qëllim apo për shkak të neglizhencës në ushtrimin e detyrës nga subjekti.

Për periudhën e vlerësimit Tetor 2013 - Tetor 2016, nuk rezultojnë të dhëna që mund të analizohen dhe vlerësohen në drejtim të cenimit të etikës, pasi ato referohen vetëm si pretendime që zgjidhen përmes rrugëve të ankimit apo që i janë evidentuar gjyqtarës në seksionet e mësipërme (2Ac, 2Ad) si një e dhënë statistikore pasi shkelja nuk rezulton të ketë qenë e kryer me qëllim apo për shkak të neglizhencës në ushtrimin e detyrës nga subjekti.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin analitik të rivlerësimit, konkludohet se: “Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me integritetin e tij ndaj çdo ndikimi ose presioni të jashtëm..”.

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtaren {...}, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur 6 ankesa (1 në vitin 2013, 3 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së. 4 ankesa (2 të vitit 2015 dhe 2 në vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 2 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më

poshtë: 1 ankesë e vitit 2013 verifikuar për zvarritje gjykimi i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik ; 1 ankesë e vitit 2015 verifikuar për zvarritje gjykimi dhe shkelje formale ligji i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.”

Sa më sipër rezulton se në konkluzionet e Inspektoriatit të KLD-së, që ka trajtuar dhe referuar ankesat respektive, nuk rezultojnë të dhëna që lidhen me integritetin e gjyqtares dhe që mund të ndikojnë në vlerësimin etik dhe profesional të saj në drejtim të këtij treguesi. Në materialet që verifikimin e ankesave rezultojnë se nuk janë konstatuar të dhëna që mund të dëshmojnë për shfaqje e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që çenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.”

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, arrin në konkluzionin se nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklarim të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit. Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë”*

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 262, datë 17.06.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilat pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pa bazuara duke konkluduar se: *“...Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, si dhe informacionet nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ai të jetë i përfshirë, apo i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshëm për vazhdimin e detyrës. Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. {...}, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.”*

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtares.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme apo sjelle që cenojnë nderin dhe dinjitetin e gjyqtares.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtares në treguesin “shmangia e sjelljeve të pahijshme, nderi dhe dinjiteti” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se: “Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara vetëm në një rast është evidentuar një kërkesë për përjashtim të subjektit të rivlerësimit {...}, për zvarritje gjykimi. Por në seancën e radhës është hequr dorë nga kërkesa për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi i çështjes. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Me përjashtim të rasteve

që lidhen me mungesën e arësytimit të plotë dhe shkak ligjor të vendimeve të ndërmjetme apo mos disponimi me këto vendime, në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale.”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Në 3 vendimet gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe aktet e 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare. Gjithashtu nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejte ose të tërthortë, në komunikimin me palët në proces ose përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarës në treguesin “shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin analitik të rivlerësimit, lidhur me kërkesat për përjashtim, konstatohet se; ”... Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara vetëm në një rast është evidentuar një kërkesë për përjashtim të subjektit të rivlerësimit {...}, për zvarritje gjykimi..”

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarës, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore.

Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e ndonjë numri të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit.

Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja si dhe 2 vendimeve të administruara për shkak të ankesave) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit⁵⁷. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit dispozitat e Ligjit për Statusin, zbatohen për aq sa është e mundur, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Për këto arsye, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit duhet të vlerësohet si i pa konsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, për në treguesin “numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” gjyqtarja pikëzohet me 15 pikë, pasi ky numër vlerësohet si “i pa konsiderueshëm”.

⁵⁷ Në dosjen nr.5 rezulton se ndaj gjyqtarës është paraqitur vetëm një kërkesë për përjashtimin e saj, kërkesë që më pas është tërhequr.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Niveli i vlerësimit ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit ne drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore), 2 vendimeve të administruar për shkak të ankesave,

rezulton se gjyqtarja, gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi është i drejtpërdrejtë dhe konkret në lidhje me çështjet për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve (*për marrjen e masave për njoftimin apo shoqërimin e të pandehurve, etj*) në aktet shkresore është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë, koncize, e saktë dhe e kuptueshme, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “komunikimi i qartë dhe transparent” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhura me short*);

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, dy vendimeve të administruar për shkak të ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për pasojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” vlerësohet “e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin analitik të rivlerësimit konkludohet se “..Në 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me kolegët apo administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në këtë aspekt duhet evidentuar se nuk ka patur asnjë seancë gjyqësore të dështuar nga planifikimi për shkaqe të organizimit të trupit gjykues apo stafit administrativ. Subjekti i rivlerësimit ka qenë pjesë e një trupi gjykues të formuar nga 3 gjyqtar (shih dosjet nr. 1-5) dhe ka bashkëpunuar me ta dhe administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave proceduralë. Në pesë raste është konstatuar vonesë në arsyetimin e vendimit dhe depozitimin e dosjes gjyqësore në sekretari”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, burime vlerësimi janë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Konstatimet e mësipërme në raportin e analizimit të aftësive profesionale, nuk tregojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë mungesën e bashkëpunimit me kolegët. Nuk ka procese të shtyra për shkak të pjesëmarrjes së gjyqtarëve në procese të tjera. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel të lartë.

KONKLuzioni

Referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, si në organizimin e procesit gjyqësor ashtu dhe në drejtim të shkëmbimit të njohurive me ta. Për shkak të shkaqeve objektive të pavarura nga gjyqtarja, ajo i ka dhënë rëndësi përfundimit të gjykimit të çështjes, edhe pse seanca ka filluar me disa minuta vonesë. Seancat gjyqësore nuk janë shtyrë asnjëherë për studimin e çështjes nga ana e gjyqtarës në cilësinë e relatores.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga te burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar një burimi si dhe prezumimit se mungesa e të dhënave për trajtimin pa respekt të punonjësve të administratës gjyqësore, keqtrajtimin e tyre nëpërmjet fjalorit të papërshtatshëm, përjashtimit social ...etj, duhet të vlerësohet si shkallë e lartë komunikimi dhe bashkëpunimi të gjyqtarit me administratën gjyqësore.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicje për mungesë të bashkëpunimit apo ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Dorëzimi me vonesë në disa raste, në sekretari, i vendimeve të arsyetuara, nuk mund të bëjë të dhënë të tërthortë që ndikon në matjen e këtij treguesi në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Referuar vlerësimit të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave të tjera për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me administratën gjyqësore, vlerësoj se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” vlerësohet “shumë e lartë” dhe pikëzohet me 10 pikë.

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;

- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit;

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar Raportin analitik të rivlerësimit, vërtetimeve me nr. 454/1 prot datë 18.10.2016, si dhe nr.54 prot, datë 19.01.2017 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetë deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se gjyqtarja {...} ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësueses dhe pjesëmarrëses.

Referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimeve me nr. 414/1 prot datë 13.10.2016 dhe nr.54 prot, datë 19.01.2017 të Shkollës së Magjistraturës, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në aktivitete trajnuese si me poshtë:

- (I) Në cilësinë e lehtësueses në Programin e Formimit Vazhdues në 1 (një) aktivitete trajnues, gjithsej 2 (dy) ditë, të zhvilluara në datat 12-13 shkurt 2015.
- (II) Në cilësinë e pjesëmarrësit në Programin e Formimit Vazhdues në 11 (njëmbëdhjetë) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 15 (shtatëmbëdhjetë) ditë trajnimi;

Duke iu referuar nenit 55, pika 9⁵⁸ të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës, pjesëmarrja në programimin e trajnimit vazhdues në cilësinë e trajnerit ose lehtësuesit ka vlerë edhe për efekt të përmbushjes së detyrimit për ndjekjen e programit të trajnimit vazhdues duke u përlogaritur 1 ditë pjesëmarrje si trajner e barabartë me 2.5 ditë si pjesëmarrës dhe 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues me 2 ditë si pjesëmarrës. Referuar këtij parashikimi, rezulton se gjyqtarja {...}, gjatë periudhës tre vjeçare të vlerësimit ka marrë pjesë në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës për 19 ditë në gjithë periudhën e vlerësimit.

Rezulton gjithashtu se gjyqtarja ka marrë pjesë në trajnimin me temë “Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve zgjedhore”, organizuar nga UNDP në Tiranë, në periudhën 27-30 maj 2013 dhe në datë 28 maj 2015, e provuar kjo me kopjen e certifikatës së dorëzuar nga gjyqtarja së bashku me formularin e vetvlerësimit.

⁵⁸Në nenin 55, pika 9 të Rregullores së Shkollës së Magjistraturës parashikohet se: “Për efekt të detyrimit ligjor për pjesëmarrje në aktivitetet e Formimit Vazhdues, përlogaritja e ditëve të gjyqtarëve dhe prokurorëve të angazhuar si ekspertë, lehtësues dhe moderatorë do të bëhet si më poshtë:

- 1 ditë pjesëmarrjeje si ekspert është e barabartë me 2.5 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si lehtësues është e barabartë me 2 ditë pjesëmarrje në trajnim;
- 1 ditë pjesëmarrje si moderator është e barabartë me 1.5 ditë pjesëmarrje në trajnim.

Ky kontribut vlen vetëm për përlogaritjen e ditëve si pjesëmarrës në Formimin Vazhdues dhe nuk sjell efekte financiare.”.

Sa më sipër, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në 11 aktivitete trajnues si lehtësuese dhe pjesëmarrëse, në programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës dhe në trajnime jashtë tij, të cilat kanë zgjatur në tërësi për 19 ditë në Shkollën e Magjistraturës dhe sipas periudhave të sipërcituara në trajnimet jashtë saj.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht të për tema që i përkasin së drejtës civile dhe familjare etj, gjithsej 11 aktivitete të zhvilluara për 19 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, vlerësohet se pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Sh. M dhe trajnime të tjera profesionale është nga 15-120 ditë dhe pikëzohet me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarës, rezulton se gjyqtarja është angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuese në 1 (një) aktivitet trajnuese, e shtrirë në dy ditë trajnimi, brenda Programit të Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} duke qenë se rezultojnë të dhëna për angazhimin e saj në cilësinë e lehtësueses në 1 (një) aktivitet trajnuese në Shkollën e Magjistraturës, ky tregues duhet të pikëzohet me 5 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si lehtësuese.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në treguesin “disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 5 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Nga burimet e vlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për pjesëmarrje të gjyqtarës në aktivitete ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, duke qene se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësi apo aktivitete të tjera.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në treguesin “angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata” gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin analitik të rivlerësimit;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Në lidhje me angazhimin e gjyqtarës në veprimtari që përfshijnë publikime ligjore akademike, nga aktet e dorëzuara nga gjyqtarja bashkëlidhur formularit të vetvlerësimit profesional, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësohet se, për gjyqtaren {...}, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton që gjyqtarja nuk ka realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, duket të vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi. Referuar sa më sipër, në treguesin “publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhim i gjyqtares dhe për këtë shkak pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Niveli i vlerësimit	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	93

NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIM

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	93	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	393	Shkëlqyeshëm

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

**KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTAREN {...}
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013 - 2016**

1. AFTËSITË PROFESIONALE				Piket total		Niveli i vlerësimit					
				100		Shkëlqyeshëm					
Treguesit		Burimet		Niveli		Piket		Të dhëna për metodologjinë			
A. Njohuritë ligjore		a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 		Shumë e lartë		25		Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
		b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 		Shumë e lartë		25		Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë	
B. Arsyetimi ligjor		a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit		<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 		Shumë e lartë		15		Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë	

					Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
	c. Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

2. AFTËSITË ORGANIZATIVE				Piket total	Niveli i vlerësimit
				100	Shkëlqyeshëm

Tregues		Burimet	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	0-10 %	15	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 3 pikë 31-40 % - 6 pikë 21-30 % - 9 pikë 11-20 % - 12 pikë 0-10 % - 15 pikë
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e 	0-10 %	5	Jashtë afatit: Mbi 40 % - 1 pikë 31-40 % - 2 pikë 21-30 % - 3 pikë

		<i>përzgjedhura me short);</i>			11-20 % - 4 pikë 0-10 % - 5 pikë
	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve	5	Koha mesatare: Më e gjatë se standardi për të gjitha kategoritë e çështjeve – 1 pikë Më e gjatë se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 2 pikë Më e gjatë se standardi për gjysmën e kategorive të çështjeve – 3 pikë Më e shkurtër se standardi për shumicën e kategorive të çështjeve – 4 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve – 5 pikë
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Mbi 99 %	10	Tej standardit : Nën 81 %- 2 pikë Mbi 81-87 % - 4 pikë Mbi 87- 93 % - 6 pikë Mbi 93-99 % - 8 pikë +99% - 10 pikë

	d. Koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve	15	Koha mesatare: Më e gjatë se afati procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 3 pikë Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 6 pikë Më e gjatë se afati procedural për gjysmën e kategorive të çështjeve- 9 pikë Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve- 12 pikë Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve – 15 pikë
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	a. Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> b. Dosja e rivlerësimit; c. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë	15	Numri mesatar i seancave dhe shkalla e aftësisë së gjyqtarit: Mbi 3 seanca dhe shkallë e dobët e aftësisë – 3 pikë Mbi 3 seanca dhe shkallë mesatare e aftësisë – 9 pikë 1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë – 15 pikë
	b. Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> c. Dosja e rivlerësimit; d. Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së 	Shumë e lartë	20	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 4 pikë Nën mesataren – 8 pikë

		vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short);			Mesatare – 12 pikë Mbi mesataren – 16 pikë Shumë e lartë - 20 pikë	
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	a. Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	5	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 1 pikë Nën mesataren – 2 pikë Mesatare – 3 pikë Mbi mesataren – 4 pikë Shumë e lartë - 5 pikë	
	b. Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	8	Shkalla e aftësisë së gjyqtarit: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë - 10 pikë	
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE					Piket total	Niveli i vlerësimit
					100	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia	
A. Etika në punë	a. Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	35	Shkalla e etikës në punë e gjyqtarit: E dobët- 7 pikë Nën mesataren – 14 pikë Mesatare – 21 pikë Mbi mesataren – 28 pikë Shumë e lartë – 35 pikë	

B. Integriteti i gjyqtarit	a. Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	40	Shkalla e integritetit të gjyqtarit : E dobët – 0 pikë Shumë e lartë – 40 pikë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	10	Aftësia për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese: E dobët- 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë- 10 pikë
	b. Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	I pa konsiderueshëm	15	Numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit: Tejet i lartë – 3 pikë I pa konsiderueshëm – 15 pikë
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL				Piket total	Niveli i vlerësimit
				93	Shkëlqyeshëm
Tregues		Burimi	Niveli	Piket	Metodologjia
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	Shumë e lartë	25	Qartësia dhe transparenca e komunikimit: E dobët – 5 pikë Nën mesataren – 10 pikë Mesatare – 15 pikë Mbi mesataren – 20 pikë Shumë e lartë – 25 pikë

	b. Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); 	I lartë	15	Respektimi i konfidencialitetit: I dobët- 3 pikë Mesatar – 9 pikë I lartë – 15 pikë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	a. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	15	Shkalla e komunikimit: E dobët – 3 pikë Nën mesataren – 6 pikë Mesatare – 9 pikë Mbi mesataren – 12 pikë Shumë e lartë – 15 pikë
	b. Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	Shumë e lartë	10	Shkalla e komunikimit: E dobët – 2 pikë Nën mesataren – 4 pikë Mesatare – 6 pikë Mbi mesataren – 8 pikë Shumë e lartë – 10 pikë
C. Gatishmëria e gjyqtarit për t’u angazhuar në veprimtari të tjera	a. Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; 	15-120 ditë	20	Pjesëmarrja e gjyqtarit: (periudha 3/vjeçare) 15-120 ditë – 20 pikë <15 ose > 120 ditë: 4
	b. Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për	<ul style="list-style-type: none"> • Dosja e rivlerësimit; 	Ka të dhëna	5	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë

	trajnimin e gjyqtarëve				
	c. Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	3	Nuk ka të dhëna – 3 pikë Ka të dhëna – 5 pikë
	ç. Publikimi ligjore akademike	<ul style="list-style-type: none"> Dosja e rivlerësimit; 	Nuk ka të dhëna	0	Nuk ka të dhëna – 0 pikë Ka të dhëna – 1 deri në 5 pikë
IVELI I VLERËSIMIT TË GJYQARIT		Shkëlqyeshëm			
IKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		393			

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR